

2022

RAPORTI VJETOR




AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



2022  
RAPORTI VJETOR

TIRANË, MARS 2023



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



## Përmbajtja

	HYRJE.....	7
1.	MESAZHI.....	9
2.	KUADRI LIGJOR.....	13
3.	RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE, PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË “PROGRES – RAPORTIT” TË BE-SË PËR SHQIPËRINË.....	15
4.	ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT NË VITIN 2022.....	18
5.	VEPRIMTARIA E AUTORITETIT PËR VITIN 2022.....	25
5.1.	ARKIVI.....	25
5.2.	INFORMIMI.....	29
5.3.	MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT DHE RIKUPERIMIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË DIKTATURËS.....	36
5.4.	HULUMTIMI SHKENCOR DHE EDUKIMI QYTETAR.....	39
5.5.	SIGURIA DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK.....	52
6.	OBJEKTIVAT E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2023.....	56
7.	SYNIMET PËR TË ARDHMEN.....	58
8.	DETYRIMET LIGJORE NGA AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSITË NË RASTET KUR LIGJI ËSHTË SHKELUR APO NUK ËSHTË KONSIDERUAR.....	60
9.	NDRYSHIMET NË KUADRIN RREGULLATOR PËR VITIN 2022 DHE EFEKTET E TYRE.....	63
10.	MBI PROBLEMATIKAT E NDESHURA NË VEPRIMTARINË E AUTORITETIT ME QËLLIM GJETJEN E RRUGËVE MË EFIKASE PËR ZGJIDHJEN E TYRE NGA KUVENDI DHE KËSHILLI I MINISTRAVE.....	66

11.	NDRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E AUTORITETIT DHE IMPAKTI I TYRE....	70
12.	ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONIT - STRUKTURA DHE ORGANIKA E AUTORITETIT.....	74
13.	TË DHËNA PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E AUTORITETIT.....	79

## HYRJE

---

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) është institucion i pavarur, organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë nga të cilët: 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kuvendi i Shqipërisë, 1 (një) anëtar i propozuar nga Këshilli i Ministrave, 1 (një) anëtar përfaqësues i propozuar nga shoqatat e të përndjekurve politikë dhe 1 (një) anëtar i propozuar nga Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Në muajin qershor 2022, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi me shumicë votash bordin e ri drejtues të Autoritetit. Kjo procedurë u ndërmor për shkak të përfundimit të mandatit të Bordit të parë të Autoritetit. Në bordin e ri u zgjodh kryetarja në detyrë e këtij institucioni, znj. Gentiana Sula, anëtari aktual i bordit z. Altin Hoxha, z. Albert Nikolla si propozim i Kryeministrit, z. Gjergj Marku u votua mes 3 kandidatëve nga shoqatat e ish-të përndjekurve dhe z. Skënder Vrioni si e vetmja kandidaturë nga organizatat e të drejtave të njeriut.

Në muajin dhjetor 2022, Kuvendi i Shqipërisë ri zgjodhi në krye të Autoritetit znj. Gentiana Sula dhe në muajin dhjetor 2022 Autoriteti kishte në përbërjen e tij, anëtarët si më poshtë vijon:

Znj. Gentiana Sula – Kryetare

Z. Albert Nikolla – Anëtar

Z. Altin Hoxha – Anëtar

Z. Gjergj Marku – Anëtar

Z. Skënder Vrioni – Anëtar

Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe për sigurimin e aksesit në ta, për të gjitha subjektet e ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar, në funksion të edukimit të publikut dhe mbështetjes së vlerave demokratike të drejtësisë, të së vërtetës, të pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme.

Raporti vjetor i punës për vitin 2022 është hartuar dhe miratuar duke u mbështetur në ligjin organik nr. 45/2015, *“Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, që normojnë dhe rregullojnë veprimtarinë funksionale të institucionit.

Në vitin 2022, ligji funksional pësoi ndryshime, të cilat përmirësuan kuadrin ligjor të veprimtarisë së institucionit sa i takon informimit, hulumtimit shkencor, edukimit qytetar dhe kontributit për të zhdukurit në komunizëm.

Në zbatim të Strategjisë 2017-2021, Autoriteti ka zhvilluar: 62 mbledhje, ku u morën 761 vendime, nga të cilat 758 vendime unanime, 3 vendime me mendim kundër, u miratuan 4 marrëveshje bashkëpunimi, janë verifikuar 210 kandidatë apo zyrtarë bazuar në 65 kërkesa institucionale, nga këta 6 figurojnë në dokumentet e ish-Sigurimit, janë trajtuar 555 aplikime individuale, 9 kërkesa për bashkëpunëtorë të zbardhura, 295 kërkesa për qëllime rehabilitimi e dëmshpërblimi dhe për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit apo burgimit, nga të cilat 67 kërkesa nga Ministria e Drejtësisë, 63 kërkesa nga ISSH-të e rretheve dhe 165 kërkesa nga individë. U trajtuan gjithashtu, 122 kërkesa studimore e mediatike, me 463 dosje të vëna në dispozicion, me rreth 60.771 faqe, nga të cilat rreth 5.854 të anonimizuara. Janë deklasifikuar 74.579 fletë dokumente arkivore, janë dixhitalizuar 1019 dosje fizike dhe 175 dosje të mikrofilmuara, me total dokumenta arkivore dhe mikrofilma në 155.844 fletë të digjitalizuar.

# 01

MESAZHI





## 1. MESAZHI

---

I krijuar në frymën e rezolutave europiane dhe shqiptare, për domosdoshmërinë e dënimit të krimeve të komunizmit, në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të të drejtave e lirive themelore të njeriut, si dhe i mbështetur në një plan strategjik ambicioz, me vizion të qartë dhe mision të përcaktuar, Autoriteti e ndërtoi punën e tij duke shërbyer si platformë e besueshme shërbimesh për individët dhe të interesuarit për akses në trashëgiminë e madhe të dokumenteve të ish-Sigurimit, që nga kërkesat individuale, institucionale, studimore e mediatike, kërkesat për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi, për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit, burgimit apo për zbardhjen e bashkëpunëtorëve, te kërkesat për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të të zhdukurve dhe ekzekutuarve. Po ashtu, si burim i aksesueshëm dhe vital për të vlerësuar të kaluarën e Shqipërisë nën regjimin diktatorial.

Një nga objektivat kryesorë të Autoritetit për vitin 2022 ka qënë [transferimi i dokumenteve arkivore në godinën e re të Autoritetit](#). Për realizimin me sukses të këtij objekti, u hartua plani i vendosjes së dokumenteve arkivore që do të tërhiqeshin nga ambjentet e arkivit që ndodhej pranë SHISH në ambjentet e arkivit, në godinën e re të Autoritetit, brenda territorit të garnizonit “Skënderbej”:

1. U përgatitën dokumentet arkivore si dhe materialet mikrofilm dhe CD që ndodheshin në 5 sallat e arkivit dhe zyrën e mikrofilmave në SHISH me qëllim fillimin e procedurave të transferimit të tyre në ambjentet e reja të arkivit. Bazuar në inventarët model 14, është bërë mbyllja me fasheta dhe lidhja e të gjithë

arkave dhe kutive me materiale arkivore para transferimit.

2. U përgatit skema e vendosjes së dokumenteve në ambjentet e reja të arkivit në godinën e Autoritetit. Çdo sallë dhe raft është pajisuar paraprakisht me të dhënave e fondeve arkivore, numrat e arkave përpara transferimit dhe në përputhje me planin e vendosjes së miratuar me Vendim nr. 26, datë 27.01.2022 të Autoritetit.
3. Transporti fizik i dokumenteve, u realizua me automjetet e vëna në dispozicion nga SHISH, sipas shkresës Nr. 2, datë 17.2.2022. Gjatë transportit fizik të dokumenteve arkivore, u respektuan të gjitha masat e nevojshme të sigurisë. Automjetet e ngarkuar me dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, u shoqëruan nga tre anëtarë të Autoritetit, nga nisja e tyre në SHISH, deri në mbërritjen e tyre në destinacion. Gjatë gjithë itinerarit të lëvizjes, automjetet që transportonin dokumentet arkivore të cituar më lart u shoqëruan edhe nga automjeti i vënë në dispozicion nga SHISH. Në këtë automjet udhëtonin dy specialistët e sigurisë së SHISH, sipas shkresës nr. 2, datë 17.2.2022.
4. Shkarkimi dhe sistemimi i dokumenteve arkivore në sallat dhe raftet e përcaktuara në planin e vendosjes së miratuar nga Autoriteti.
5. Procesi i transferimit ka filluar më datë 28.02.2022 dhe ka përfunduar më datë 16.03.2022, duke u dokumentuar me procesverbalet përkatëse të daljes nga ambjentet e arkivit në SHISH dhe të hyrjes në ambjentet e godinës së Autoritetit.

Një tjetër objektiv i realizuar në vitin 2022, është [përmirësimi i ligjit funksional nr. 45/2015, i cili pësoi ndryshime dhe shtesa në dispozita të veçanta të tij](#), të cilat nëpërmjet adresimit të pengesave në legjislaclacionin ekzistues, shfuqizimit të dispozitave ndaluese ligjore që

e pengonin Autoritetin të dispononte mbi kompetencën e dhënë nga ligjvënësi, vënies në dispozicion të mjeteve dhe mekanizmave ligjorë të nevojshëm për realizimin e qëllimit të ligjit, ndihmojnë në implementimin e saktë dhe pasqyrimin me vërtetësi dhe transparencë të veprimtarisë, përmirësojnë dhe harmonizojnë kuadrin ligjor të veprimtarisë së institucionit me ligje të tjera, zgjerojnë rrethin e subjekteve që informohen, duke iu shërbyer jo vetëm atyre që kanë qenë drejtpërdrejtë subjekte të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, por çdo qytetari shqiptar që kërkon të njohë historinë e njërit prej regjimeve më të egra komuniste, si edhe mediave apo hulumtimit shkencor, duke siguruar garanci nëpërmjet zbatimit të procedurave gjatë hetimit administrativ, mbrojtjen e të dhënave personale dhe bashkëveprimit me institucione qendrore etj.

**Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrja e të rinjve në promovimin e vlerave evropiane,** përmes njohjes së historisë që kemi jetuar si shoqëri, është një ndër sfidat e Autoritetit për 5-vjeçarin e ardhshëm, duke filluar me përgatitjen e mësuesve, për t'u ofruar atyre metodologjinë e qasjes ndaj argumentit dhe mjetet e nevojshme didaktike për ta realizuar si duhet procesin në klasë, deri tek përfshirja në kurrikulat e arsimit parauniversitar të njohurive mbi veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ndërtimi dhe përditësimi i platformës **“Të mësojmë mbi të shkuarën 1944-1991- Burime arsimore të hapura”**, e cila do të përmbajë informacione në pikëprerje horizontale dhe vertikale të histories, duke u ndalur në data e personazhe që kanë shënuar të shkuarën e vendit nën regjimin komunist. Ndërtimi i kësaj platforme do të kërkojë ekspertizën e ekspertëve të historisë, për ndërtimin e narrativës kombëtare mbi të shkuarën me fakte e dokumente. Historia do të vijë në formën e infografikave, animimeve dhe timeline-ve interaktive, të

cilat do të ravijëzojnë e më tej do të thellohen sipas listës së ngjarjeve të kalendarit të kujtesës. Në këtë ndërfaqe do të krijohet mundësia e marrjes dhe dhënies së opinioneve, diskutime mbi ngjarjet dhe personazhet, refleksione, informacione etj, të cilat do të krijojnë tablonë e plotë të narrativës.

Në total, që nga krijimi në 2017 e në mbyllje të vitit të gjashtë të punës, janë verifikuar gjithsej 2.399 kandidatë, nga të cilët 2.322 rezultojnë pa dokumente, ndërsa 77 rezultojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit si bashkëpunëtorë, ose punonjës të strukturave të ish-Sigurimit, ose anëtarë të trupës gjykuese në procese politike që lidhen me fushën e veprimit të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, 24 marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar me partnerë brenda vendit dhe jashtë tij.

Sot, të gjitha vendimet e Autoritetit mbi kandidatët dhe zyrtarët e verifikuar, kërkesat individuale, institucionale, studimore dhe mediatike, publikohen periodikisht në buletinët e përdymuajshëm, në letër dhe në faqen zyrtare, si dhe shpërndahen gjërisht online.

Aktivitete të rëndësishme u organizuan nga institucioni, i cili mori rol qendror në debatin publik për çështje të së shkuarës komuniste, si kampi i Tepelenës, të zhdukurit në komunizëm, artistët e shkrimtarët eurvejuar, emigracioni politik, ku me tryeza të rrumbullakëta, konferenca, simpoziume shkencore dhe dialogë lokalë në mbarë vendin, arriti të pozicionohej mes institucioneve të kujtesës, me rol në të sotmen dhe të ardhmen e Shqipërisë.

Presidenti i Republikës, me propozim të Autoritetit, për disa vite rresht, nderoi 13 figura të solidaritetit dhe dinjitetit njerëzor. Bashkia Elbasan, me propozim të Autoritetit, nderoi me titullin **“Qytetar Nderi”** (pas vdekjes) Atë Josif Papamihalin, i zhdukur në kampin

e Maliqit. Rruga “26 shkurti” në Mënik të Tiranës dhe Muzeu i Shkencave të Natyrës “Sabiha Kasimati” në Tiranë morën emërtimet përkatëse me propozime të Autoritetit.

Dy memorialë të punuar dhe zbatuar nga Autoriteti janë vendosur për herë të parë në dy vende kujtuese, në Tepelenë dhe në Maliq, aty ku deri më sot nuk kishte pllakatë informuese.

59 libra si dhe publikime online, ekspozita fizike dhe virtuale, dëshmi e dokumentarë, janë prodhuar nga Autoriteti, në bashkëpunim me partnerë, të cilët prezantohen në faqet online të institucionit, që me vitet ka përshkallëzuar mundësinë për të arritur te brezat, shoqëria, publiku.

Materialet e hulumtuara janë përkthyer në anglisht për të ndërkombëtarizuar kauzat e ndërmarra dhe janë prezantuar në botë.

Tre faqe online administrohen sot nga Autoriteti, në vijim të projekteve të mëhershme, “Edhe muret kanë veshë”, me dëshmi gojore, [www.dosjet.gov.al](http://www.dosjet.gov.al), me profilet e të dënuarve politikë, kundërshtarë të sistemit, platforma e leximit ISSUU dhe rrjetet sociale, ku Autoriteti punon për të qenë i pranishëm, i arritshëm dhe sa më afër të rinjve.

Përveç përmasës tematike, edhe gjeografikisht, në Shqipëri e jashtë saj, në 5 vjet janë prekur tema në rëndësishme si: në Shkodër, Malësi të Madhe, Vermosh, Pukë, Burrel, Kurbin, Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnjë, Belsh, Savër, Gostimë, Berat, Korçë, Voskopojë, Maliq, Përmet, Tepelenë, Gjirokastrë, Himarë, Sarandë, Konispol. Po ashtu, është punuar me institucionet ndërkombëtare dhe diasporën shqiptare në SHBA, Belgjikë, Gjermani, Poloni, Çeki, Sllovaki, Bullgari, Hungari, Rumani,

Estoni, Izrael.

Sot Shqipëria është pjesë e Rrjetit European të Institucioneve të ish-Policive Sekrete, dhe vijon të jetë e pranishme si anëtare vëzhguese e ENRS, ku ka integruar Ministrinë e Kulturës.

Partnerë aktivë të Autoritetit në vite kanë qenë Prezenca e OSBE në Tiranë, PNUD në Shqipëri, Bashkimi European, ambasada amerikane, gjermane, suedeze, zvicerane, italiane, polake, izraelite, ICMP.

Autoriteti e gjen veten me bilanc pozitiv sa i takon ndërtesës, arkivit, shërbimit të dokumentacionit, rolit në komunikimin publik, rritjes së ndërgjegjësimit për të zhdukurit në komunizëm.

# KUADRI LIGJOR

# 02

## 2. KUADRI LIGJOR

---

Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara nga baza ligjore e mëposhtme:

Ligjin nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”; Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Shërbimet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”; Ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë; Ligjin nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave Personale” i ndryshuar; Ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”; Ligjin nr. 119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e Informimit”; si dhe në akte nënligjore të mëposhtme: Vendim i Kuvendit të Republikës nr. 95, datë 22.12.2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 15.02.2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritete të tjera publike”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 935, datë 28.12.2016 “Për kalimin nën përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të shtetit, të objektit nr. 52, me emërtim “Arkivi

i Ri”, Brenda Territorit të Pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, me vendndodhje lagjia nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 515, datë 18.07.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar, me anë të së cilës është përcaktuar mjedisi në të cilin AIDSSH do të ushtrojë veprimtarinë e vet; Vendimi nr. 93, datë 27.02.2020, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”; Ligj Nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë”.

**Akte rregullatore të brendshme të Autoritetit:** Rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit; Rregullore “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në AIDSSH”, miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 14.04.2017; Rregullore “Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në AIDSSH”, miratuar me Vendimin nr. 25, datë 25.05.2017, të Autoritetit; Rregullore “Mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, përmes buletinit në letër apo online në faqen e Autoritetit”;

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Autoriteti ndihmohet nga Sekretariati Teknik, sipas detyrave të përcaktuara në ligjin organik dhe rregullave të mirëpërcaktuara në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Autoritetit. Sekretariati Teknik përgatit dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin, realizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të Autoritetit.

**RESPEKTIMI DHE  
PLOTËSIMI I DETYRIMEVE  
NDËRKOMBËTARE,  
PËRMBUSHJAE  
REKOMANDIMEVE TË  
“PROGRES - RAPOR-  
TIT” TË BE-SË PËR  
SHQIPËRINË**

### 3. RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE, PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË “PROGRES – RAPORTIT” TË BE-SË PËR SHQIPËRINË

---

“Pa paqe, stabilitet, respektim të të drejtave të njeriut dhe qeverisje efektive, të mbështetur në sundimin e ligjit, nuk mund të shpresohet për zhvillim të qëndrueshëm, në një botë me shoqëri të polarizuar, ku vijoje ciklet e konflikteve dhe dhunës”.

#### Kombet e Bashkuara

Edhe gjatë vitit 2022, Autoriteti ka kontribuar në përmbushjen e rekomandimeve të Grupit të Punës të OKB-së për Personat e Zhdukur (WGEID), ku Kombet e Bashkuara pohojnë për Shqipërinë se, forcimi i ligjit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në institucionet e drejtësisë dhe përmirësimit të proceseve të drejtësisë tranzitore, ndihmon sigurimin e së vërtetës, e ridimensionon atë dhe u jep zë viktimave, elemente që vënë themelet për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqe në shoqëri.

Autoriteti ka vijuar punën për krijimin e mundësive për një hap cilësor për sa i takon çështjes së gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist.

Është drejt finalizimit projektvendimi: “Për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur gjatë komunizmit”. Projektvendimi u është shpërndarë Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Ministrisë së Brendshme, të cilët paraqitën komentet e tyre me shkrim për këtë projektvendim.

Është punuar në drejtim të orientimit të zgjidhjes për çështjen e personave të zhdukur gjatë regjimit

diktatorial, me institucionet, komunitetet, duke mbrojtur më të dobët, forcuar zbatimin e ligjit dhe mbështetur respektimin e të drejtave të njeriut, si elementë kyç të procesit. Për këtë, janë hartuar dhe dërguar shkresat përkatëse për procesin e gjetjes së eshtrave të personave të zhdukur, për të cilat Autoriteti ka të dhëna të besueshme për vendndodhjen e tyre, konkretisht Morgut Tiranë, Policisë së Tiranës dhe për dijeni Prokurorit të Përgjithshëm, Bashkisë së Kolonjës, prokurorisë Korçë dhe Drejtorisë Vendore Korçë, Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe Kryetarit të Bashkisë Shkodër.

Kontributi i Autoritetit në përmbushje të misionit për mbrojtjen e interesit publik dhe sigurisë kombëtare, pajtimit dhe unitetit kombëtar, ligjshmërisë, informimit të publikut me informacion zyrtar dhe mbrojtjen e së drejtës për jetë private dhe të dhënave personale, në kuadër të transparencës dhe bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore, në zbatim të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, ka qenë i ndjeshëm përgjatë vitit 2022.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet për qartësimin e fatit të të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti nënshkroi më datë 03.02.2022, marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për garantimin dhe realizimin e një procesi të rregullt ligjor të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën gjatë periudhës së komunizmit.

#### Bashkimi Europian

Sipas raportit-progresit 2022 të Komisionit Europian për Shqipërinë, në kapitullin “Pajtimi dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore” nënvizohet “Nevoja për përfundimin e procesit të deklasifikimit të dosjeve të krijuara nga Ish-

Sigurimi i Shtetit, duke i bërë ato të aksesueshme për studiuesit dhe publikun e gjere me qëllim përparimin e drejtësisë dhe pajtimit”.

Në këtë kuadër, Autoriteti, përgjatë 2022, ka intensifikuar punën për deklasifikimin e dosjeve, duke përjashtuar ato që çënojnë sigurinë kombëtare dhe ka vijuar me digjitalizimin e tyre.

Me ndryshimet ligjore, kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet një pune të kujdesshme kur të dhënat mund të çënojnë sigurinë kombëtare dhe të drejtat e njeriut, nëpërmjet përdorimit të kufizimeve të përcaktuara në akte ndërkombëtare dhe të legjislacionit shqiptar.



**ZBATIMI I REZOLUTËS  
SË KUVENDIT PËR  
VLERËSIMIN E  
VEPRIMTARISË SË  
AUTORITETIT NË VITIN  
2022**

#### 4. ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT NË VITIN 2022

---

- a. Të vijojë angazhimin për hartimin e draftit të aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë autoritetet përgjegjëse dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar, ose të dyshuara, duke dhënë kontribut në përcaktimin e detyrave të Autoritetit në këtë proces, por edhe më gjerë, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore qendrore dhe vendore. Organizimi i tryezave teknike me partnerë.

##### Organizimi i tryezave teknike me partnerë

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka organizuar disa tryeza teknike pune mbi identifikimin dhe rikuperimin e trupave të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, (4 nëntor 2021, 22 shkurt 2022, 6 Prill 2022, etj).

Në këto tryeza pune, Autoriteti është përfaqësuar nga titullari i Autoritetit dhe grupi i punës. Nuk ka munguar në këto takime prania e përfaqësuesve nga OSBE-ja, KAS-i, BE-ja, përfaqësues të institucioneve shqiptare si: Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Mjekësia Ligjore, Policia e Shtetit, ICMP në Shqipëri etj. Në të gjitha takimet e zhvilluara, është orientuar puna dhe detyra e secilit institucion/organ për zbatimin e procedurave hap pas hapi deri në finalizimin e VKM-së.

Në ndihmë dhe për qëllim të këtij procesi është marrë një ekspert i jashtëm, i financuar nga ICMP dhe KAS, i cili ka paraqitur një draft fillestar të diskutuar me

përfaqësuesit e mësipërm dhe të dakordësuar nga Autoriteti, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe ICMP-ja.

##### Ndërtimi i bazës së të dhënave të ADN-së

Për procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, është ndërtuar një bazë të dhënash, e detajuar, për personat e zhdukur në raport me personat kërkues, e cila do të shërbejë si Regjistër i Personave të Zhdukur dhe si pikënisje e procesit të identifikimit dhe rikuperimit. Në këtë kuadër, informacioni do të jetë më i plotë pas plotësimit me dokumentacionin e siguruar si pjesë e Komunikatave Ditore nga Ministria e Brendshme dhe pas përpunimit të tyre.

Objektiv tjetër, për të cilin po punohet, është krijimi i bazës së të dhënave të ADN-së së të afërmeve të personave të zhdukur. Në lidhje me këtë, është diskutuar me përfaqësues të ICMP-së në Shqipëri dhe të Institutit të Mjekësisë Ligjore, të cilat kanë rënë dakord në parim për mbështetjen e Autoritetit në këtë proces. Përfaqësuesi i Institutit ka pranuar kërkesën e ICMP-së për inventarizimin e eshtrave që janë depozituar në Institut.

- b. Të vijojë përpjekjet për dorëzimin e dokumenteve të ish - Sigurimit të Shtetit nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme, në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me autoritetet publike dhe arkivat për zbatimin e detyrimeve ligjore.

Është nënshkruar urdhri i përbashkët me Ministrinë e Brendshme, Nr. 103, datë 14.06.2022, *“Për kalimin e fondeve arkivore nga Ministria e Brendshme tek Autoriteti dhe vendosjen e rregullave për shfrytëzimin e tyre”*.

Nëkuadërtë bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me Ministrinë e Brendshme, janë dorëzuar dokumentet e fondeve arkivore si më poshtë:

- I. Fondi “Hetimor-Gjyqësor”: 13967 dosje, nga të cilat rreth 93.000 fletë janë digjitalizuar, në zbatim të marrëveshjes me operatorin ekonomik “Alfa”;
- II. Dega e Sigurimit në ushtri, Reparti nr. 8001: 268 dosje të vendosura në 5 kuti;
- III. Dega e Sigurimit në ushtri, Reparti nr. 5858: 151 dosje të vendosura në 3 kuti;
- IV. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës: 255 dosje të vendosura në 6 kuti;
- V. Fondi nr. 49, Dega e Hetuesisë: 172 dosje të vendosura në 3 kuti.

Janë digjitalizuar 30 kuti me 195 dosje, me 45305 fletë, të fondit nr. 142, “Komunikata ditore”.

Në bazë të urdhrit të përbashkët me Ministrinë e Brendshme, Nr. 103, datë 14.06.2022, do të vazhdojë dorëzimi dhe digjitalizimi i dokumenteve të tjera sipas detyrimeve ligjore.

**c. Të intensifikojë bashkëpunimet me institucionet qeveritare për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm, në komunikim me familjet, grupet e interesit, pushtetin vendor dhe organizatat ndërkombëtare.**

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet, për qartësimin e fatit të të zhdukurit gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti ka nënshkruar, më datë 03.02.2022, marrëveshjen nr. 165 prot. me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për “Garantimin dhe re-

*alizimin e një procesi të rregullt ligjor për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të atyre që u zhdukën gjatë periudhës së komunizmit”.*

### Kërkesa për informim mbi personat e zhdukur

Gjatë vitit 2022, nga të afërm të personave të zhdukur, janë depozituar **94 kërkesa** sipas Formularit Tip të miratuar nga Autoriteti. Në lidhje me aspektin gjinor, 12 prej kërkesëve gra dhe **1 në 2** raste personi i zhdukur është grua. Ndërsa, përsa i përket vendndodhjes së zhdukjes së personave, bazuar në informacionet e deritanishme, është e vështirë të përpunohet informacioni për lokacione masive. Lokacione, për të cilat ka më shumë se një rast, referohen: Burgu i Burrelit, Burgu i Gjirokastrës, Burgu i Shkodrës dhe Kampi i Tepelenës.

Në **85** kërkesa për dokumentacion drejtuar Ministrisë së Brendshme, **4** kanë rezultuar me të dhëna dhe në **38** kërkesa për dokumentacion drejtuar Drejtorisë së Burjeve **11** kanë rezultuar me të dhëna.

Në total **203** kërkesa janë regjistruar pranë Autoritetit që nga viti **2017- 2022**, për qartësimin e fatit të të zhdukurve.

### Komunikata Ditore të Ministrisë së Punëve të Brendshme

Për të pasur shifra të sakta për personat që kanë ndërruar jetë në institucionet e dënimit, personat e zhdukur në kufi, apo të tjera kategori, si rezultat i bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme, Fondi i Komunikatave Ditore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për periudhën 1949 – 1991, me një total prej 30 kutish (195 Dosje), 45305 faqe digjitale, është skanuar nga Autoriteti

Qëllimi i këtij procesi është informimi në rang të gjerë

mbi numrin e personave që kanë vdekur gjatë regjimit komunist, për të mundësuar në vijim kategorizimin e rasteve.

### Vendosja e memorialeve në kujtim të personave të zhdukur gjatë regjimit diktatorial

Bazuar në marrëveshjen nr. 831/11, datë 10.08.2020, e ndryshuar, të AIDSSH-së dhe ICMP-së, për projektin “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit të komunizëm”, dhe në vijim të kërkesave të mëparshme për projektin, në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, që Autoriteti “të vazhdojë aktivitetet në kuadër të edukimit qytetar dhe kërkimit shkencor, duke angazhuar grupet e interesit dhe përfshirë të rinjtë në aktivitetet për rishikimin e historisë dhe vënien në vend të dinjitetit njerëzor të personave që vuajtën regjimin totalitar dhe të të zhdukurve në komunizëm”, në muajin shkurt të vitit 2022, janë realizuar ekspozitat e jashtme, pllakatat informuese përkujtimore për të zhdukurit në Maliq, në kthesën e Pocestës, me informacion për jetët e humbura, si dhe pranë ish-kampit të internimit në Tepelenë, të cilat kanë në fokus informimin mbi jetën e vështirë në këto kampe, të dënuarit, jetët e humbura në kamp, skica mbi jetën e vështirë dhe punën e detyruar, të dhëna statistikore mbi të zhdukurit.

Memorialet e përuara në fillim të vitit 2022 në Tepelenë dhe Maliq, të parët pas 30 vitesh rënie të komunizmit, janë hapi tjetër i madh, i qëndrueshëm, në vijim të dialogut me pushtetin lokal dhe grupet e interesit, për kthimin në vende kujtese të kampeve dhe bërjen e tyre të vizitueshme.

### Vizitë studimore në Kroaci

Gjatë datave 21 deri më 23 shtator, tre përfaqësues

nga Autoriteti, zhvilluan një vizitë studimore në Kroaci, me objekt njohjen me përvojën institucionale kroate për identifikimin dhe rikuperimin e personave të zhdukur. Kjo vizitë studimore u mundësua nga organizata Konrad-Adenauer-Stiftung dhe prezenca e OSCE në Shqipëri<sup>1</sup>.

Modeli kroat u vlerësua si një model që mund të shërbejë e të merret në konsideratë edhe në rastin e Shqipërisë.

Në fund, në vijim dhe takimeve të tjera me OSCE, u bë me dije që të planifikohej organizimi i një takimi tre palësh ndërmjet Prokurorisë, Autoritetit dhe Ministrisë së Brendshme.

### d. Të bëjë funksional sistemin e arkivit digjital për lehtësim të procesit të kërkimit dhe konsultimit me dokumentet arkivore sipas standardeve ndërkombëtare.

Sistemi i arkivit digjital është instaluar në kompjuterat e secilit nëpunës, janë bërë trajnimet përkatëse, është në fazë testimi dhe pasurimi me materiale.

Ka filluar përdorimi i sistemit për shkëmbimin e dokumenteve midis dy drejtorive Drejtorisë së Arkivit dhe Drejtorisë së Informacionit, vënia në dispozicion për anonimizim nga Drejtoia e Informacionit dhe pas përfundimit të procesit të anonimizimit dërgimin në Drejtorinë e Arkivit për hedhjen në CD.

<sup>1</sup> Pjesëmarrësit e tjerë në vizitën studimore ishin përfaqësues nga institucione të ndryshme të përfshira në proces. Nga Instituti i Mjekësisë Ligjore ishte z. Zija Ismaili, nga Laboratori i Policisë Shkencore ishte z. Aleksandër Bushati, nga Prokuroria e Përgjithshme ishte znj. Anila Leka, nga OSCE ishte znj. Erjola Lika, dhe nga Konrad-Adenauer-Stiftung ishte znj. Zheni Korçari. Në vizitën studimore nuk mundën të ishin pjesëmarrës z. Luigj Ndou nga ICMP, për shkak të ndalimit në Aeroportin e Rinasit në lidhje me skadimin e pashaportës, dhe znj. Alma Mele nga Ministria e Brendshme, për shkak të lëvizjes nga pozioni përgjegjës në lidhje me personat e zhdukur.

e. Të bashkëpunojë ngushtë me ISKK-në për sa i takon shfrytëzimit të dokumentacionit arkivor sipas parashikimeve ligjore, me qëllim garantimin e mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve nga ana e studiuesve duke mbështetur kërkimin shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish- Sigurimit të Shtetit.

Në bazë të marrëveshjes ndërinstucionale me ISK-PK-në, janë trajtuar 5 kërkesa studimore gjatë vitit 2022.

Për studiuesit e Institutit janë vënë në dispozicion publikatë 32 dosje me një total prej 2010 faqe, ndërsa 204 të tjera me një total prej 14.305 faqe janë miratuar për konsultim nga studiuesit pranë zyrave të Autoritetit.

Praktikat e ISKK-së janë trajtuar nga DMSHEQ gjithnjë me prioritet në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional, konform dispozitave ligjore në fuqi.

f. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucione homologe të huaja, me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira nga veprimtaria e tyre.

Gjatë vitit 2022 Autoriteti ka organizuar një sërë aktivitete në kuadër të bashkëpunimit institucional me homologë të ndryshëm, për shkëmbimin e përvojave me vende të cilat prezantojnë modelet më të mira në shërbim të pajtimit, paqes dhe ndërtimit të Kujtesës Europiane;

Në këtë kuadër Autoriteti ka marrë pjesë në:

➤ Simpoziumin e dhjetë të Kujtesës Evropiane, i cili u zhvillua më 1-3 qershor 2022, në Dublin, në të cilin u trajtua formësimi perceptimit publik të historisë në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar,

çështje që lidhen me historinë dhe përkujtimin e ngjarjeve dhe figurave të caktuara historike, të cilat janë gjithnjë e më të spikatura në diskursin akademik, politik dhe publik;

➤ Takimin e përvitshëm të Rrjetit European të Arkivave të ish-Policive Sekrete, më 28-30 qershor, i cili u zhvillua në Budapest, nga Arkivi Historik i Shërbimeve Sekrete Hungareze (ABTL), në cilësinë e mbajtësit të Presidencës së radhës së Rrjetit. Për periudhën 2023-2024, sipas dokumentit të themelimit të Rrjetit, presidenca do t'i kalojë Shqipërisë;

➤ Konferencën me titull “Historia dhe kujtesa në marrëdhëniet ndërkombëtare”, të organizuar nga ENRS (Rrjeti European i Kujtesës dhe Solidaritetit), në Varshavë, Poloni, në datat 26-28 tetor 2022, ku u trajtuan tema në lidhje me kujtesën në nivel ndërkombëtar, tipologjitë e ndryshme të saj, për dëshmitë gojore, përkufizimin e memorjes, aktorët dhe veprimet që duhen ndërmarrë, u trajtuan vendet e kujtesës, memorja politike, historia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare etj., nga ekspertë të fushës, të universiteteve e institucioneve të vendeve të ndryshme. Mesazhet e dhëna ishin të forta dhe shumë të rëndësishme për t’u ndjekur në punën e përditshme me memorjen në vendin tonë.

➤ Në zbatim të planit vjetor 2022, si dhe në kuadër të misionit të Autoritetit për hedhjen dritë mbi të shkuarën komuniste të vendit, një ekip i Autoritetit, në drejtimin e Kryetares Znj. Gentiana Sula, mbajtën aktivitete të rëndësishme, gjatë një vizite disaditore në Bruksel, në datat 13 dhe 14 dhjetor 2022. Në takimet me përfaqësues të Komunitetit Shqiptar

në Belgjikë, përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian e më tej, në organizimin për shfaqjen e Filmit “Edhe muret kanë veshë”, një prodhim i Autoritetit për Informim me Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, Autoriteti u mbështetet nga Maison Culturelle Belgo-Albanese (Qendra Kulturore Belgo - Shqiptare) dhe Ambasada e Shqipërisë në Belgjikë. U prezantua puna e bërë nga Autoriteti në lidhje me zbardhjen e së shkuarës komuniste të Shqipërisë, nëpërmjet hapjes së dokumenteve, dhënies së tyre për të interesuarit, konferencave shkencore, studime në lidhje me emigracionin politik etj, ekspozitat me dokumente arkivore, si dhe punës në kuadër të gjetjes së të zhdukurve në diktaturë, u shpreh se. Takimet shërbyen për vendosjen e urave lidhëse mes shoqërisë shqiptare në atdhe dhe komunitetit shqiptar në Belgjikë. Gjatë vizitës, Autoriteti u takua me përfaqësues të Komisionit Evropian, me të cilët foli për hapat që ka bërë Shqipëria në drejtim të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, si dhe rolin që luan kujtesa dhe zbardhja e të shkuarës në funksion të kristalizimit të demokracisë, vendosjes së shtetit ligjor dhe promovimit të pajtimit kombëtar. Përfaqësuesit e Komisionit Evropian për Shqipërinë u njohën me punën e institucionit, sfidat e tashme e të së ardhmes, si dhe ndryshimet e reja ligjore që zgjerojnë veprimtarinë e Autoritetit. Ekipi bëri një përmbledhje të punës së arritur deri më sot për zbardhjen e të shkuarës komuniste në vend, që nis me hapjen e dokumenteve të ish-Sigurimit për viktimat, studiuesit dhe median, gjashtë vjet më parë. Në mbyllje të aktiviteteve të datës 14.12.2022, u shfaq për komunitetin shqiptar në Belgjikë, dokumentari “Edhe muret kanë veshë”, i cili erdhi si bashkëpunim i Autoritetit me shoqatën ‘Vlera’, një organizatë e studentëve shqiptarë që studiojnë dhe punojnë në Bruksel.

➤ Në datat 8 dhe 9 dhjetor 2022 u mbajt në Qendrën Memoriale të Srebrenicës, Potoçari (Bosnje dhe Hercegovinë), takimi ndërkombëtar i ekspertëve me titull: “Kontribut i arkivave për drejtësinë tranzicionale dhe më gjerë”, në të cilin Autoriteti për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit u përfaqësua nga dy specialistë të fushës. Ky takim ndërkombëtar i ekspertëve ishte një kombinim i mirë i përvojës shkencore, akademike rreth rolit që kanë arkivat në fushën e kujtesës, drejtësisë tranzicionale si dhe njohjes me vendngjarjen, vende të kujtesës të ngjitur në kujtim të genocidit që ndodhi në Srebrenicë në korrik të vitit 1995.

g. Të intensifikojë punën për deklasifikimin e dosjeve, duke përjashtuar ato që çenojnë sigurinë kombëtare dhe të vijnë me digjitalizimin e tyre.

Për të gjitha kërkesat të cilat kanë rezultuar me dokumente që përmbajnë informacion të klasifikuar është realizuar kërkimi, studimi i dokumenteve, përgatitja e relacioneve për deklasifikim.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2022 janë hartuar relacionet për propozim deklasifikimi, janë zhvilluar 16 mbledhje të KDZH-së dhe janë marrë 30 Vendime sipas së cilave janë deklasifikuar 769 njësi arkivore (dosje, fashikuj etj) me një total prej 74579 fletë dokumente arkivore

Me ndryshimet ligjore, kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet një pune të kujdesshme kur të dhënat mund të çenojnë sigurinë kombëtare dhe të drejtat e njeriut, nëpërmjet përdorimit të kufizimeve të përcaktuara ligjore ne akte ndërkombetare dhe te legjislacionit shqiptar.

Me ndryshimet e ligjit nr. 45/2015, miratuar me ligjin

nr. 72/2022, konkretisht neni 18, të gjitha dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të parashikuara në këtë ligj për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë konsiderohen të deklasifikuara.

j .Të publikojë në faqen zyrtare online të Autoritetit, për sa lejohet nga kuadri ligjor, listën e individëve që kanë rezultuar si bashkëpunëtorë të ish- Sigurimit të Shtetit dhe që janë pjesë e administratës publike.

Bibliografite e dokumenteve të deklasifikuara i janë dërguar DSIK dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare për publikim në fletoren zyrtare, si dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH-së.

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, Programin e Transparencës së Autoritetit, Ligji nr. 9887, datë 10.08.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* të ndryshuar, urdhërat, udhëzimet dhe vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, publikimi në faqen zyrtare i listës së individëve që kanë rezultuar si bashkëpunëtorë të ish- Sigurimit të Shtetit dhe që janë pjesë e administratës publike çënon imazhin, të drejtat e shtetasve, jetën private dhe të dhënat personale të subjekteve të tjera dhe në këtë kontekst veprimtaria e Autoritetit do të jetë në mënyrë të panevojshme e kontestueshme në gjykatë në çdo rast. Për mbrojtjen e të dhënave personale ekziston një legjislacion i gjerë vendas dhe ndërkombëtar, i cili është në bazën e punës të institucioneve ligjzbatuese që përbëhet nga Akte ndërkombëtare:

- Deklarata Universale e të drejtave dhe lirive të njeriut;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, amenduar nga Protokollin nr.11, hyrë në fuqi më 1 Nëntor 1998;
- Direktivat 95/46/EC dhe 2002/58/EC të Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian;
- Konventa e Këshillit të Evropës *“Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale”*, ratifikuar me Ligjin nr.9288, datë 7.10.2004;
- Protokollin shtesë i Konventës së KE *“Për Mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe lëvizjen ndërkufitare të të dhënave personale”*, ratifikuar me ligjin nr.9287, datë 7.10.2004;

Referuar legjislacionit shqiptar në fushën e së drejtës për informimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, gjen zbatim si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*;
- Ligji nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*;
- Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 *“Për arkivat”*;
- Ligji nr. 45/2015 *“Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, i ndryshuar.



**VEPRIMTARIA E  
AUTORITETIT  
PËR VITIN 2022**



## 5. VEPRIMTARIA E AUTORITETIT PËR VITIN 2022

### 5.1. ARKIVI

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 45, datë 30.04.2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti ka krijuar arkivin e tij për mbledhjen, ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit. Ky arkiv organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit – miratuar me Vendim të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit nr. 21, datë 09.05.2017, i ndryshuar, ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, (i shfuqizuar), ligji nr. 10/2023 “Për Informacionin e Klasifikuar”, ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor të Republikës së Shqipërisë, akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të ligjeve të sipërcituara.

#### Transferimi i arkivit në ambjentet e reja të institucionit

Një nga objektivat kryesorë të Autoritetit për vitin 2022 ka qenë transferimi i dokumenteve arkivore të dorëzuara nga SHISH sipas procesverbalit nr. 1, datë 19.01.2017, (SHISH nr. 160 Prot., 18.01.2017) në godinën e re të Autoritetit. Në zbatim të VKM 98/2017 këto dokumente dhe materiale arkivore ruheshin në 5 (pesë) salla arkivi dhe një zyrë, ambjente këto të vëna në dispozicion nga SHISH që prej vitit 2017 deri në përfundimin e transferimit në arkivin e Autoritetit.

Për realizimin me sukses të këtij objekti, u hartua plani i

vendosjes së dokumenteve arkivore që do të tërhiqeshin nga ambjentet e arkivit që ndodhej pranë SHISH në ambjentet e arkivit në godinën e re të Autoritetit brenda territorit të garnizonit “Skënderbej”, i cili u miratua me Vendimin nr. 26, datë 27.1.2022 “Për miratimin e planit të vendosjes së dokumenteve arkivore që do të tërhiqen nga ambjentet e arkivit që ndodhen pranë SHISH”, si dhe Urdhrit nr. 310, datë 25.2.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për transferimin fizik të dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit që ruhen në arkivin e Autoritetit që ndodhet në ambjentet e SHISH.

Në mbështetje të bazës ligjore së mësipërme, u bë e mundur:

1. Përgatitja e dokumenteve arkivore si dhe materialeve mikrofilm dhe CD që ndodheshin në 5 sallat e arkivit dhe zyrën e mikrofilmave në SHISH me qëllim fillimin e procedurave të transferimit të tyre në ambjentet e reja të arkivit. Bazuar në inventarët model 14, është bërë mbyllja me fasheta dhe lidhja e të gjithë arkave dhe kutive me materiale arkivore para transferimit;
2. Përgatitja e skemave të vendosjes së dokumenteve në ambjentet e reja të arkivit në godinën e Autoritetit. Çdo sallë dhe raft është pajisuar paraprakisht me të dhënat e fondeve arkivore, numrat e arkave përpara transferimit, në përputhje me planin e vendosjes së miratuar me Vendim nr. 26, datë 27.01.2022 të Autoritetit;
3. Transporti fizik i dokumenteve, u realizua me automjetet e vëna në dispozicion nga SHISH, sipas shkresës Nr. 2, datë 17.2.2022. Gjatë transportit fizik të dokumenteve arkivore, brenda automjetit kanë qenë të pranishëm punonjësit e Drejtorisë së Arkivit, dhe Drejtorisë së Sigurisë e Zhvillimit Teknologjik. Automjetet e ngarkuara me dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, u shoqëruan nga tre prej anëtarëve të Autoritetit nga nisja e tyre

në SHISH deri në mbërritjen e tyre në destinacion. Gjatë të gjithë itinerarit të lëvizjes, automjetet që transportonin dokumentet arkivore të cituara më lart u shoqëruan edhe nga automjeti i vënë në dispozicion nga SHISH. Në këtë automjet udhëtonin dy specialistët e sigurisë së SHISH, sipas shkresës nr. 2, datë 17.2.2022;

4. Shkarkimi dhe sistemimi i dokumenteve arkivore në sallat dhe raftet e përcaktuara në planin e vendosjes së miratuar nga Autoriteti;
5. Procesi i transferimit ka filluar më datë 28.02.2022 dhe ka përfunduar më datë 16.03.2022, duke u dokumentuar me procesverbalet përkatëse të daljes nga ambjentet e arkivit në SHISH dhe të hyrjes në ambjentet e godinës së Autoritetit.

#### Transferimi i arkivit në ambjentet e reja të institucionit

*Fondi nr. 1 - Hetimor-Gjyqësor, 13969 njësi arkivore të vendosura në 901 kuti*

Në zbatim të Vendimit të Autoritetit Nr. 322, datë 21.07.2012 *“Mbi transferimin fizik të dokumenteve arkivore të Fondit Hetimor-Gjyqësor”*, këto dokumente dhe materiale arkivore ruheshin në 2 (dy) salla arkivi, ambjente këto të vëna në dispozicion nga Ministria e Brendshme pranë IPQP-së që prej vitit 2018 deri në përfundimin e transferimit në arkivin e Autoritetit.

Për realizimin me sukses të këtij objektiv, u hartua plani i transferimit fizik të dokumenteve arkivore të fondit hetimor-gjyqësor nga ambjentet e Ministrisë së Brendshme (ASMB) që ruhen pranë IPQP-së, në ambjentet e arkivit, në godinën e re të Autoritetit brenda territorit të pronës nr. 12 me emërtim *“Komanda e doktrinës dhe stërvitjes”*, i cili u miratua me Vendimin nr. 322, datë 21.7.2022 *“Mbi transferimin fizik dhe marrjen në dorëzim të dokumenteve të fondit hetimor-gjyqësor që ruhen në arkivin e*

*sistemit të Ministrisë së Brendshme në territorin e IPQP”*.

Në mbështetje të ligjit 45/2015, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 322, datë 21.07.2012, *“Për miratimin e planit të vendosjes së dokumenteve arkivore që do të tërhiqen nga ambjentet e arkivit që ndodhen pranë SHISH*, u realizuan:

1. Përgatitja e dokumenteve arkivore që ndodheshin në sallat e arkivit me qëllim fillimin e procedurave të transferimit të tyre në ambjentet e reja të AIDSSH, duke verifikuar çdo kuti që të mund të jetë me etiketën përkatëse, e cila duhet të identifikojë në mënyrë të saktë të dhënat dhe referencat arkivore për sigurimin e kohezionit të materialit arkivor;
2. Mbyllja me fasheta dhe lidhja e të gjitha kutive me materiale arkivore para transferimit, me qëllim që asnjë material arkivor të mos transportohet i pavendosur në kuti;
3. Përgatitja e skemave të vendosjes së dokumenteve në ambjentet e reja të arkivit në godinën e AIDSSH;
4. Verifikimi fizik në nivel dosje dhe risistemimi i tyre në kutitë ekzistuese të kartonit;
5. Zëvendësimi i kutive të vjetra me kuti të reja të arkivit përpara vendosjes së materialeve arkivore në sallën nr. 1 si dhe pajisjen me etiketën përkatëse ku u shënuan të gjitha referencat që kishin kutitë e vjetra;
6. Vendosja e materialeve në rafte duke ruajtur skemën e vjetër të organizimit të tyre, me qëllim përdorimin e aplikacionit përkatës që shërben për kërkimin e të dhënave edhe pas transferimit.

Verifikimi i dokumenteve arkivore në rafte pas vendosjes së dokumenteve sipas listës shoqëruese dhe procesverbaleve të daljes nga godina e arkivit pranë IPQP.

#### Ruajtja dhe shërbimi i dokumenteve arkivore

Ruajtja dhe mirëmbajtja e materialeve arkivore të grumbulluara duke garantuar se dokumentet nuk do të lexohen, kopjohen, ndryshohen, asgjësohen apo largo-

hen pa autorizim, është një nga detyrat kryesore funksionale të Autoritetit.

Kjo detyrë është ndjekur dhe zbatuar në të gjitha ambjentet ku ruhen dhe administrohen dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit të marra në dorëzim nga Autoriteti, duke përfshirë sallat ku ruhen dokumentet arkivore në ambjentet e SHISH (deri më 28.2.2022), sallat e arkivit në godinën e re të Autoritetit, sallat ku ruhen dokumentet e Fondit të dosjeve hetimore-gjyqësore pranë IPQP, kjo e fundit për aq sa parashikohet në marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme.

Për përmbushjen me sukses të kësaj detyre, strukturat përkatëse:

1. Kanë respektuar me rigorozitet protokollin e hyrje-daljeve në mjediset e arkivit, që përfshin regjistrimin në regjistra, autorizimin përkatës, datën, orën, qëllimin e hyrjes dhe nënshkrimin;
2. Kanë kryer procedurat e hapjes, ajrosjes dhe kontrollit të ambjenteve ku ruhen dokumentet në mënyrë periodike;
3. Kanë respektuar skemat e vendosjes fizike të dokumenteve arkivore gjatë përdorimit të tyre me qëllim ruajtjen e kohezionit arkivor;
4. Kanë marrë masat e duhura që në të kryhet procedura e dezinfektimit dhe deratizimit të sallave të arkivit sipas parashikimeve të Normave tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivore në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar në këtë mënyrë mbrojtjen e dokumenteve arkivore nga dëmtimet që mund të vijnë nga prania e mikroorganizmat;
5. Në mënyrë të vashdueshme është treguar kujdes në përdorimin e dokumenteve arki-

vore, në mënyrë të veçantë dokumentet e vjetra dhe shumë të vjetra.

Shërbimi i dokumenteve arkivore për qëllime dhe sipas kërkesave të miratuara në Autoritet si dhe digjitalizimi i tyre për informimin e qytetarëve, studiuësve/medias dhe institucioneve është realizuar në përputhje të plotë me Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, ligjit “Për arkivat”, Normat Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë për dokumente arkivore që nuk përmbajnë informacion të klasifikuar dhe sipas dispozitave të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre. Pjesë e këtyre procedurave është numërimi fletë për fletë, si dhe dhënia e tyre për shfrytëzim.

#### Grumbullimi dhe marrja në dorëzim e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit

Në zbatim të ligjit 45/2015, i ndryshuar, VKM 98/2017, Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Mbi procedurat e kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, të materialeve arkivore të ish Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, Urdhri i Përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, nr. 103, datë 14.6.2022, Drejtoria e Arkivit ka marrë në dorëzim dokumentet e fondeve arkivore si më poshtë:

1. Fondi Dega e Sigurimit të Reparti 5851 Tiranë (1983-1991) të vendosura në 3 kuti;

2. Fondi Dega e Sigurimit të Reparti 8001 Shkodër (1969-1991) të vendosura në 5 kuti;
3. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, 255 dosje, të vendosura në 6 kuti;
4. Fondi nr. 49, Dega e Hetuesisë, 172 dosje, të vendosura në 3 kuti;
5. Fondi 142 Komunikatat Ditore (1979-1991) të vendosura në 30 kuti, ne formatin e digjitalizuar.


### Trajtimi i kërkesave

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar neni 44, pika 4 dhe 5, pritjet përmirësimin i punës dhe efektiviteti në dhënien e shërbimeve subjekteve kërkuese, pasi kërkesat do të shqyrtohen në një afat kohor më të shkurtër për shkak të deklasifikimit *ex legge* të dokumentacionit arkivor me nivel klasifikimi.

Ndryshimet ligjore të pikës 5, të nenit 44, parashikojnë mundësinë e riklasifikimit kur gjykohet se çënohet siguria kombëtare dhe mardhëniet ndërkombëtare. Por ligji për informacionin e klasifikuar parashikon qartë që, riklasifikimi bëhet vetëm nga autoriteti që ka krijuar informacionin e klasifikuar. Dokumentacioni arkivor që administron Autoriteti është dokumentacion i trashëguar dhe jo i krijuar nga Autoriteti, gjë e cila e bën të pamundur riklasifikimin e tij. Për këtë arsye Autoriteti është në kushtet e zbatimit të nenit 6, të ligjit nr. 45/2015, që parashikon kufizimin e përdorimit të të dhënave të dokumenteve të cilat çënojnë sigurinë kombëtare.

### Deklasifikimi i dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”

Një tjetër proces pune shumë i rëndësishëm, i cili kryhet nga Drejtoria e Arkivit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij është edhe përgatitja e praktikave të plota për mbledhjet e KDZH-së.



Grafiku nr.2: Paraqitja në formë grafike e ecurisë së vendimeve të KDZH janar-dhjetor 2022

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë hartuar relacionet për propozim deklasifikimi, janë zhvilluar **16** mbledhje të KDZH-së dhe janë marrë **30** Vendime, në bazë të të cilave janë deklasifikuar **769** njësi arkivore (dosje, fashikuj etj) me një total prej **74 579** fletë dokumente arkivore, sikurse është ilustruar më poshtë:

*Grafiku nr.2: Paraqitja në formë grafike e ecurisë së vendimeve të KDZH janar-dhjetor 2022*

Bibliografite e dokumenteve të deklasifikuara i janë dërguar DSIK dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare për publikim në fletoren zyrtare, si dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH-së.

### Digjitalizimi i dokumenteve

Gjatë vitit 2022 janë digjitalizuar **1019** dosje fizike dhe **175** dosje të mikrofilmuara, me një total prej **114 577** faqe dokumente arkivore, sikurse janë pasqyruar më më poshtë.

Të gjithë dokumentet e digjitalizuar janë rregjistruar në pajisjen e ruajtjes (serverin) dhe rregjistrin elektronik përkatës.

Përveç digjitalizimit, janë përgatitur dhe vënë në dispozicion CD me dokumentet e anonimizuara nga Drejtoria e Informacionit dhe Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe

Edukimit Qytetar. Pas kryerjes së procesit të anonimizimit nga sektorët përkatës, Sektori i Digjitalizimit ka kryer procedurat e arkivimit në server të dokumenteve të anonimizuar dhe ka përgatitur (djegur) 132 CD për vënie në dispozicion të kërkuesve.

Gjithashtu, në zbatim të Vendimit nr. 406 datë 13.9.2021 të Autoritetit për “Projektin e digjitalizimit të regjistrave të përpunimit, regjistrave të internim/ dëbimeve si dhe Vendimeve të Komisionit Qendror të Internim Dëbimeve, ka përfunduar skanimi i të gjithë regjistrave të përpunimit.

### 5.2. INFORMIMI

Gjatë vitit 2022, në zbatim të planit vjetor të punës, të hartuar duke patur parasysh objektivat e vendosura në Planin Strategjik dhe atij të Veprimit, është punuar për përmbushjen e objektivave të Autoritetit në kuadër të krijimit të lehtësirave në procedurat për kërkesa të institucioneve publike dhe qytetarëve për:

- verifikimin e zyrtarëve që konkurojnë për t’u zgjedhur ose emëruar në detyra publike;
- informimin e individëve mbi dokumente të ish - Sigurimit të Shtetit;
- përmbushjen në kohë dhe me cilësi të detyrave

Nr.	Numri i dosjeve	Numri i faqeve
Dosje fizike	1019 dosje	114.577
Dosje mikrofilm	175 dosje	41267
<b>Totali</b>	<b>1194</b>	<b>155.844</b>

*Tabela nr.1: Paraqitja në formë tabelare e dokumenteve të digjitalizuar janar- dhjetor 2022*

funkionale dhe ndihmëse në funksion të nevojave e prioriteteve;

- përfshirjen e ndryshimeve të reja ligjore në aktet themelore të Institucionit dhe përshtatjen e punës në funksion të tyre.

Ndërmjet të tjerash, objekti dhe qëllimi kryesor i veprimtarisë së Autoritetit është të sigurojë të drejtën e çdo qytetari për të parë informacionin e krijuar ose të mbledhur rreth tyre, nga ish-Sigurimi i Shtetit. Sipas ligjit, të afërmit (trashëgimtarët) mund të shikojnë edhe dosjet e një anëtarit të familjes që nuk jeton, sipas rendit ligjor të trashëgimisë, vetë ose duke pajisur me prokurë një person tjetër. Qytetarët do të jenë në gjendje të fitojnë qasje në këto dosje pas dorëzimit të një kërkesë pranë Autoritetit, e cila duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar ligjor. Gjithnjë në përputhje dhe respektim të dispozitave në fuqi, për të mbrojtur të drejtën e privatësisë së çdo pale të tretë dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetin e të gjithë personave. Ofrimi i aksesit sa më parë në këto dokumente mbetet prioritet i Autoritetit.

### Kërkesa individuale

Gjatë kësaj periudhe është punuar në procesin e përmirësimit e përpunimit të mëtejshëm si dhe sqarimit e ndihmës në lidhje me formularët e kërkesave për informim nga individët dhe ata mbi vendin e vuajtjes së dënimit dhe internim-dëbimet për efekt pensioni. Janë hartuar dhe miratuar formularët mbi të pagjeturit në përshtatje me udhëzuesin përkatës dhe ndryshimet ligjore në përmbushje të detyrave që dalin nga rezoluta e kuvendit.

Në periudhën 12-mujore, janar – dhjetor 2022, në gjuhën e shifrave rezultoi se:

- Janë paraqitur në Autoritet **555** kërkesa individuale;

- Janë legjitimuar **537** kërkesa individuale, nga këto 20 kërkesa janë të 2021;
- Janë mbyllur **573** kërkesa individuale nga të cilat:
  - **215** kërkesa me dokumentacion arkivor;
  - **297** kërkesa pa dokumentacion arkivor;
  - **17** kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh;
  - Janë ndjekur me prioritet dhe përfunduar **204** kërkesa të mbartura nga viti 2018, 2019, 2020 dhe 2021 nga të cilat:
    - **112** kërkesa me dokumentacion arkivor;
    - **67** kërkesa pa dokumentacion arkivor;
    - **16** kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh;
    - **7** kthim përgjigje;
    - **2** kaluar tek DZH
- Gjatë vitit 2022 u janë dorëzuar qytetarëve **317** kërkesa me vendimet dhe fletët e anonimizuara dhe të digjitalizuara me një volum prej rreth **38.000** faqesh;
- Përgjatë 2022 është bërë përpunimi i më shumë se **72.000** faqeve, nga të cilat **24.000** faqe janë të anonimizuara.



Viti	Nr. i kërkesave të mbërritura	Të përfunduara		Kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh
		Me të dhëna arkivore	Pa të dhëna arkivore	
2022				
	<b>529</b>	<b>215</b>	<b>297</b>	<b>17</b>

Në ushtrim të detyrës është punuar me prioritet në kuadër të procesit të mbrojtjes të të dhënave gjatë përpunimit dhe dhënies së informacionit, në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar si dhe zbatimi i përpiktë i ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën për Informim”, krahas garantimit të integritetit të procesit në përgjithësi në dhënien e informacionit, duke e bërë këtë të fundit, lehtësisht të aksesueshëm, të saktë dhe të plotë, për aq sa e lejon ligji, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, interesit publik dhe sigurisë kombëtare.

Në vlerësimin tonë dhe perceptimin publik të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”, qëllimi përcaktues dhe detyra prioritare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është dhe për një kohë të gjatë do të mbetet, marrja në shqyrtim e kërkesave të paraqitura nga individët.

### Kërkesa individuale për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi

Gjatë vitit 2022 janë paraqitur në Autoritet **295** kërkesa për internim-dëbim ose burgim, nga të cilat:

- **67** kërkesa nga Ministria e Drejtësisë;
- **63** kërkesa nga ISSh-të e rretheve;
- **165** kërkesa nga individë;

Autoriteti trajton kërkesa për vërtetim të periudhës së internimit, mbështetur në ligjin 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në bazë të Vendimit nr. 91, datë 04.03.2019 të Autoritetit.

Gjatë trajtimit të kërkesave për periudhën e internimit, jemi ndeshur me faktin që një numër i konsiderueshëm i kërkesave vijnë nga persona që kanë lindur në internim ose janë internuar kur kanë qenë minorenë së bashku me familjarët e tyre. Problematika e hasur në lidhje me këto kërkesa është fakti se për këta persona nuk gjenden të dhëna arkivore, pasi Komisioni i Internim-Dëbimit nuk merrte vendime për të lindurit në internim dhe minorenët. Nisur nga ky fakt, Autoriteti ka dalë me përgjigje negative për këtë kategori personash dhe për këtë arsye ata nuk përfitojnë dot shtesën e pensionit për periudhën e internimit që kanë kryer.

Për sa i përket personave të cilët kanë qenë minorenë, në kohën e internimit të tyre, Komisioni i Internim-Dëbimit nuk merrte vendime për ta si subjekte, që do të thotë se Autoriteti nuk e ka të mundur të gjejë të dhëna arkivore për këtë kategori subjektesh, e për rrjedhojë nuk mundet t’u kthejë përgjigje lidhur me kërkesat e tyre. Duke marrë në konsideratë gjithë sa më sipër, lidhur me subjektet që ligji i parashikon si të përshtatshëm për të përfituar dëmshpërblime financiare, do të ishte me vend që, në objektin e ligjit përcaktuar në nenin 1 të tij, të përfshiheshin edhe personat, të cilët kanë qenë minorenë, duke vërtetuar lidhjet faktike me praninë e tyre në kampet e internimit, duke qenë së padyshim kjo periudhë ka shenjuar edhe jetën e tyre, dhe si e

tillë duhet t'i nënshtrohet trajtimit me dëshmipërblimin përkatës. Kjo gjë mund të arrihet vetëm duke e parashkuar kushtin e vendosur për vërtetimin e periudhës së internimit me dokumente të krijuara si burime arkivore përpara datës 1.10.1991, në nenin 1 të ligjit, si një kusht alternativ dhe jo shterues.

Për arsye se në dosjet hetimore-gjyqësore nuk gjenden të dhëna për numrin e repartit ku të burgosurit kanë kryer dënimin, në bashkëpunim me sektorin e kërkesave individuale për dosje të identifikuar më parë (nga trajtimi i kërkesës individuale që kërkuesi ka bërë) është bërë e mundur identifikimi i materialeve nga dosjet e përpunimit, ku cilësohet vendi ku të burgosurit kanë kryer dënimin.

Viti	Ardhur	Mbyllur
2017	95	65
2018	184	115
2019	135	153
2020	118	99
2021	344	295
<b>2022</b>	<b>295</b>	<b>290</b>
<b>Totali</b>	<b>1171</b>	<b>1017</b>

### Kërkesa për informim të institucioneve

Në vijim të *“Rekomandimit lidhur me shmangien e përdorimit dhe emërimit të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike me data dhe simbole që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist”* të Avokatit të Popullit, me shkresën me Nr. Dok. 202101682/2 datë 09.02.2022, dhe në kuadër të transparencës së veprimtarisë e sidomos të rritjes dhe ruajtjes së besimit të publikut në punën e institucioneve, Autoriteti i është drejtuar me shkresë Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Tiranë, si dhe çdo bashkie dhe këshilli bashkiak në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të ushtrojnë pushtetin ekzekutiv dhe kontrollues **në bazë të kompetencave territoriale** që kanë në bazë të ligjit për:

- i. marrjen e masave për të filluar me procedurat për verifikimin, evidentimin e rasteve të përdorimit të emërtimeve me data, simbole apo emra të figurave të regjimit komunist;
- ii. paraqitjen e kërkesës për trajtim dhe kompetencë pranë Autoritetit me të dhënat e nevojshme për kryerjen e verifikimit, nëse ekzistojnë informacione në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, pasi Autoriteti nuk e nis procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës kryesisht ose me iniciativën e tij, por vetëm pasi të bëhet kërkesa nga subjekti për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij;
- iii. fillimin e procedurave për ndryshimin e emërtimeve që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist të rrugëve dhe hapësirave publike, duke e konsideruar si përgjegjësi e shoqërisë së sotme ndaj atyre që u persekutuan, internuan, vuajtën, u vranë ose u zhdukën padrejtësisht;
- iv. Paraqitjen e kërkesave për verifikim të kandidatëve përpara dekorimit ose dhënies së titujve të nderit, në zbatim të nenit 26 pika 2, të ligjit 45/2015 dhe në zbatim të ligjit nr. 112/2013 *“Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”*



Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, shumë organe të pushtetit vendor kanë vlerësuar zbatimin korrekt të ligjit nga ana e Autoritetit dhe kanë mirëpritur kërkesën, për të nisur bashkëpunimin me qëllim ruajtjen e besimit të publikut në punën e institucioneve, por vetëm 9 bashki nga 61 prej tyre kanë paraqitur 22 kërkesa për verifikim të pastërtisë së figurës të 60 shtetasve të propozuar, për 1 kandidat për emërim ngritje në detyrë, 15 kandidatë në kuadër të dhënies së titujve vendor të nderit “Qytetar Nderi”, apo dekorim nga ana e Bashkive dhe 44 kandidatë të propozuar për emërtimin e disa hapësirave të territorit publik.

#### Janë mbyllur procedurat e verifikimit për 42 shtetas.

Mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti, vetëm për gjashtë kandidatë, për emërtimin e disa hapësirave të territorit publik, apo dekorim e tituj nderi, kanë rezultuar dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, nga të cilët 5 figurojnë si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit, ndërsa 1 kandidat si dëshmitar në çështje penale politike.

Përveç kërkesave të pushtetit vendor për verifikim të kandidatëve për emërtimin e disa hapësirave të territorit publik apo dekorim të shtetasve, Autoriteti, gjatë vitit 2022, ka kryer, brenda afateve të kërkuara nga insti-

tucionet, procedurat për vlerësim të cilësive etiko-morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u zgjedhur në organet e reja të vetingut dhe atyre për t’u zgjedhur në/nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, insitucioni i Presidentit të Republikës, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike, Akademia e Shkencave dhe institucione të tjera të paraqitura.

Në total, për periudhën janar – dhjetor 2022, nga Autoriteti janë marrë 81 vendime dhe janë verifikuar 210 kandidatë, nga të cilët vetëm për 6 kandidatë rezultojnë dokumente, pra figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit si b.p., ose si dëshmitarë në procese politike.

Në vitin 2022, ligji funksional nr. 45/2015 pësoi ndryshime dhe shtesa në dispozita të veçanta të tij, të cilat nëpërmjet adresimit të pengesave në legjislacionin ekzistues, shfuqizimit të dispozitave ndaluese ligjore që e pengonin Autoritetin të dispononte kompetencën e dhënë nga ligjvënësi, vënies në dispozicion të mjeteve dhe mekanizmave ligjorë të nevojshëm për realizimin e qëllimit të ligjit, ndihmojnë në implementimin e saktë dhe pasqyrimin me vërtetësi dhe transparencë të veprimtarisë, përmirësojnë dhe harmonizojnë kuadrin ligjor të veprimtarisë së institucionit me ligje të tjera,

Viti	Nr.i kërkesave	Kandidatë të verifikuar	Kandidatë pa të dhëna	Figurojnë në dokumente	Vendime
2022	65	210	204	68	1

**Në raport me të njëjtën periudhë një-vjeçare raportimi, për vitin 2021 ka një ulje në numrin e kandidatëve për verifikim gjithsej 214 nga 397 të paraqitur në vitin 2021. Gjithashtu janë verifikuar 210 nga 349 kandidatë të verifikuar në vitin 2021, pra për vitin 2022 kemi më pak kandidatë të verifikuar se në vitin 2021. 6 kandidatë kanë rezultuar me probleme, krahasuar me vitin 2021, ku rezultojnë 14 kandidatë. Faktor ndikues moshë shumë e re e disa kandidatëve të verifikuar.**

zgjerojnë rrethin e subjekteve që informohen, duke u shërbyer jo vetëm atyre që kanë qenë drejtpërdrejt subjekte të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, por çdo qytetari që kërkon të njohë historinë e njërit prej regjimeve më të egra komuniste, si dhe mediave apo studiuesve e kërkuesve shkencorë, duke siguruar garanci nëpërmjet zbatimit të procedurave gjatë hetimit administrativ, mbrojtjen e të dhënave personale, bashkëveprimin me institucione qendrore etj.

Tashmë është shfuqizuar dispozita e nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, që parashikonte: *“Autoriteti nuk administron kërkesa për informacion për zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, kur Autoriteti administron apo i është vënë në dispozicion dokumenti autentik origjinal i certifikatës së pastërtisë së figurës, shoqëruar me vendimin përkatës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar*. Në zbatim të kësaj dispozite, çdo subjekt që dispononte certifikatën e pastërtisë së figurës apo vendimin përkatës nga institucionet përgjegjëse, gëzonte mbrojtjen ligjore të dispozitave të ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, *“Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar*.

Ligji nr. 8043, datë 30.11.1995 *“Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, në nenin 16 të tij, parashikonte gjithashtu “Në mungesë të dispozitave të tjera ligjore ndalohet marrja kontakt me dokumentacionin objekt i këtij ligji për vendime që lidhen me personat pas vitit 2001 e deri në vitin 2025 (me përjashtim të institucione-*

*ve përgjegjëse të ngarkuara nga ligji)”. Me ndryshimet ligjore të fundit, kjo dispozitë është shfuqizuar.*

Ligji i ndryshuar me një amendament të ri gjithashtu parashikon që: *“Çdo person të gëzojë të drejtën të njihet me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në ligjin, “Për të drejtën e informimit”, dhe të kërkojë një kopje të tyre”. Si rezultat i këtij ndryshimi ligjor, në Autoritet, është vënë re interes i shtuar që reflektohet në numrin e rritur të kërkesave për informim bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, interes i shfaqur nga qytetarë të shumtë, por sidomos nga studiues dhe media për të marrë informacion dhe dokumentacion.*

Ndryshimet në ligjin nr. 45/2015, i ndryshuar, të cilat synojnë të plotësojnë boshllëqet në legjislacionin ekzistues, lidhur me verifikim e figurës së kandidatëve për deputetë ose kryetarë bashkish nga Autoriteti, heqin barrierat ligjore në kryerjen e verifikime të zyrtarëve të pajisur më herët me certifikatë nga Komisionet Mezini dhe Bezhani.

Pas ndryshimeve ligjore dhe interesit të lartë të publikut për mënyrën se si është kryer verifikimi i figurave nga këta komisione, u miratua ngritja e Grupit të Punës me objekt *“Identifikimin dhe njohjen e akteve juridike dhe veprimtarisë së dy institucioneve përgjegjëse, lidhur me procesin e kontrollit të figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë në Republikën e Shqipërisë, listës me bazë të dhënash të dokumentacionit arkivor të krijuar, procesin e grumbullimit, marrjen në administrim dhe përpunim të fondit, numrin e zyrtarëve të verifikuar prej tyre dhe rezultatit e verifikimit, rastet dhe procedurat gjyqësore të ankimeve, kuadrin ligjor ndërkombëtar në kryerjen e verifikimit të zyrtarëve dhe personave të tjerë”, me qëllim hartimin e një raporti përmbledhës që i kontribuon përmbushjes të misionit të Autoritetit, mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare,*

pajtimin dhe unitetin kombëtar, ligjshmërisë, informimin të publikut me informacionin zyrtar, mbrojtjes së të drejtës për jetë private dhe të dhënave personale, në kuadër të transparencës dhe bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore, në zbatim të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke hequr mbrojtjen ligjore që jepte dispozita, zgjerohet verifikimi i figurës së subjekteve, duke përfshirë edhe çdo shtetas të propozuar për dekorim me titull nderi apo për emërtimin e rrugëve, shesheve, hapësirave publike dhe monumenteve historike e kulturore, nga institucionet dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre, që të garantohet që nuk kanë lidhje me ish-Sigurimin e Shtetit si bashkëpunëtorë, anëtarë apo të favorizuar. Këtu përfshihet edhe marrja e informacionit nga persona të tretë që rezultojnë në këto dokumente, në funksion të hedhjes dritë mbi të vërtetën, mbi saktësimin e gjeneraliteteve të zyrtarëve që verifikohen.

Këto detyra të reja të ngarkuara janë sa të rëndësishme, po aq voluminoze dhe kërkojnë punë të dedikuara. Vlen të theksohet fakti se, nisur nga interesi i lartë publik, pranë Autoritetit janë paraqitur me iniciativë, 6 (gjashtë) kërkesa nga deputetë në detyrë të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe shumë kërkesa nga bashki të ndryshme që kërkojnë verifikimin e shtetasve të propozuar për tituj nderi etj., në përputhje me kompetencat ligjore të pushtetit vendor, ndërsa me ndryshimin që ka pësuar neni 27, i ligjit 45/2015 pritet të rritet fluksi edhe lidhur me kërkesat për verifikim të shtetasve të propozuar për emërtimin e rrugëve shesheve dhe hapësirave publike.

Nëse për dy zgjedhjet parlamentare, të vitit 2017 me 18 parti të regjistruara, dhe vitit 2021 me 31 parti të regjistruara, vetëm për katër parti të vogla politike janë verifikuar gjithsej 446 kandidatë për deputetë dhe për 5 kandidatë për deputetë figurojnë të dhëna në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit si bashkëpunëtorë, në

zgjedhjet e ardhshme qendrore dhe vendore, me paketën e propozimeve për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor, pritet të kryhet verifikimi i të gjithë kandidatëve që do të regjistrohen në zgjedhje.

Po kështu, si pjesë e paketës me ndryshime ligjore, pritet që, lidhur me procesin e integritetit të zyrtarëve që emërohen apo zgjidhen në detyrë, Autoriteti të verifikojë një numër më të madh zyrtarësh, duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera në kryerjen e hetimit administrativ gjatë procedurës së verifikimit të zyrtarëve.

E drejta për informim është një nga të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë, zbatueshmëria e së cilës realizohet nga bashkëpunimi efektiv mes qytetarëve dhe autoriteteve publike.

Bazuar në ligjin nr. 119/2014, *“Për të drejtën e Informimit”*, gjatë vitit 2022 është shfaqur interes në rritje nga qytetarë të shumtë, por sidomos nga studiues dhe media, për të kërkuar informacion publik, si dhe për të marrë dokumentacion.

Është krijuar dhe plotësuar Regjistri Elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit, si një sistem që mundëson qasje më të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe grupeve të interesit në informacion publik, duke shmangur burokracinë.

Gjatë vitit 2022, janë paraqitur 15 kërkesa për informacion dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit, kryesisht nga mediat, por edhe nga qytetarë, në lidhje me procesin e verifikimit të zyrtarëve dhe vendimarrjen përkatëse. Për çdo kërkesë është dhënë përgjigje, në rrugë zyrtare, mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga subjekte që u lind kjo e drejtë, duke respektuar dispozitat e ligjit nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, ligjit nr. 9887, datë 10.08.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* të ndryshuar dhe ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.

### 5.3. MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT DHE RIKUPERIMIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË DIKTATURËS

Lidhur me temën e të zhdukurve gjatë regjimit komunist, në vitin 2022, ka patur zhvillime të rëndësishme. Në kuadër të ndryshimeve të fundit në ligjin 45/2015, si pjesë e Autoritetit, u krijua Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur. Një strukturë që është përgjegjëse për komunikimin administrativ ndërmjet institucioneve përgjegjëse që janë të përfshira në proces. Drejtoria, e miratuar me pesë punonjës, do të ketë si fushë veprimi bashkëpunimin ndërinstitucional për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe marrjen e masave për ruajtjen e vendvarrimeve, duke plotësuar çdo komunikim institucional të Autoritetit me institucionet përgjegjëse, ndjekjen e projekteve të dedikuara, duke krijuar kështu një tablo të qartë të të gjithë veprimtarisë për të pagjeturit, përfshirë edhe aktorët e tjerë në këto procese, sa delikat, aq edhe human.

#### Kërkesat e mbërritura për personat e zhdukur

Gjatë vitit 2022, një aspekt i rëndësishëm ka qenë administrimi i kërkesës për personat e zhdukur, të paraqitur nga familjarët e të zhdukurve gjatë regjimit komunist, ku njëherazi atyre u është bërë me dije që mund të japin dëshmi/rrëfime etj., në funksion të saktësisimit të të dhënave dhe mbledhjes së informacionit për qartësimin e fatit të të zhdukurve. Autoriteti në bashkëpunim me ICMP-në është në proces për standardizimin e rekomandimit të familjarëve të të zhdukurve për dhënien e ADN-së në funksion të procesit.

Gjatë periudhës së raportimit, nga të afërm të personave të zhdukur, janë depozituar **94** kërkesa. Në lidhje me aspektin gjinor, **12** prej kërkesave janë të gjinisë femërore dhe në 2 raste personi i zhdukur është grua, 1 rast personi i zhdukur është fëmijë i moshës **7 vjeç**, gjithashtu 1 rast personi i zhdukur është foshnje e sapolindur. Sipas specifikimeve në kërkesa gjetjeve arkivore, viti i zhdukjes apo ekzekutimit të personave i përket, në pjesën më të madhe, periudhës **1945 deri në 1960**, ndërsa për vendndodhjen, është e vështirë të përpunohet informacioni për lokacione masive. Ato lokacione, për të cilat ka më shumë se një rast, është *burgu i Burrelit, burgu i Gjirokastrës, burgu i Shkodrës dhe Kampi i Tepelenës*.

1. Përsa i përket kërkimit arkivor në Autoritet nga **82** kërkesa:
  - **23** kërkesa me të dhëna arkivore;
  - **25** kërkesa pa të dhëna;
2. Në **85** kërkesa drejtuar Ministrisë së Brendshme:
  - **4** kërkesa me të dhëna arkivore;
  - **81** kërkesa pa të dhëna arkivore;
3. Në **38** kërkesa drejtuar për dokumentacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve:
  - **11** janë me të dhëna;
  - **27** pa të dhëna;

Në total janë **221** kërkesa janë regjistruar pranë Autoritetit për periudhën 2017- 2022, për qartësimin e fatit të të zhdukurve.

<b>Kërkesa të paraqitura nga qytetaret për të qartësuar fatin e të vdekurit apo të zhdukurit ne vitin 2022</b>			
94 kërkesa te reja janë regjistruar për të qartësuar fatin e të vdekurit apo të	82 kërkesa janë legjitimuar	82 Kërkesa për dokumentacion Drejtorisë së Arkivi	23 përgjigje me të dhëna
zhdukurit gjatë vitit 2022	nga Autoriteti	48 Përgjigje nga Drejtoria e Arkivit	25 përgjigje pa të dhëna
<b>Kërkesa Institucioneve për Informacion për të qartësuar fatin e të vdekurit apo të zhdukurit ne vitin 2022</b>			
66 kërkesa Ministrisë së Brendshme për informacion gjatë vitit 2022	4 përgjigje me të dhëna nga Ministria e Brendshme		
	62 përgjigje pa të dhëna nga Ministria e Brendshme (3 janë kërkesa te vitit 2022)		
21 Kërkesa Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	4 përgjigje me të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve		
	14 përgjigje pa të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (2 janë kërkesa te vitit 2022)		

### Ndërtimi i databazës së ADN-së

Ka filluar puna me ndërtimin e databazës së detajuar për personat e zhdukur, në raport me personat kërkues, e cila do të shërbejë si një Regjistër i Personave të Zhdukur për nisjen e procesit të identifikimit dhe rikuperimit. Në këtë kuadër, informacioni do të jetë më i plotë pas marrjes së Komunikatave Ditore nga Ministria e Brendshme.

Hap tjetër, për të cilin po punohet, është krijimi i databazës së ADN-së së të afërmeve të personave të zhdukur. Në lidhje me këtë është diskutuar më përfaqësues së ICMP-së në Shqipëri dhe të Insitutit të Mjekësisë Ligjore dhe është rënë dakord, në parim, për mbështetjen e Autoritetit në këtë proces. Përfaqësuesi

i Insitutit ka pranuar kërkesën e ICMP-së për inventarizmin e eshtrave që janë depozituar në Insitut.

### Procesi e miratimit të VKM-së

Sfidë mbetet miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave, i cili duhet të rregullojë procedurat për identifikimin dhe rikuperimin trupave të personave të zhdukur. Ky akt normativ është vendimtar, pasi kuadri ligjor aktual përcakton institucionet përgjegjëse, por nuk parashikon teknikat se si duhet të zhvillohet i gjithë procesi.

Në zbatim të nenit 22/1 të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti ndërmori iniciativën e hartimit të draft-VKM-së: “Për gjetjen, identifikimin dhe rikuperim-

*in e eshtrave të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të personave të zhdukur në këtë periudhë”.*

Lidhur me këtë, Autoriteti ka përgatitur një draft-dokument, të cilin e ka dërguar pranë institucioneve përgjegjëse si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, etj. Kërkesa për bashkëpunim dhe konsultim me këta institucione, për marrjen e komenteve prej tyre për këtë çështje, ka krijuar disa divergjenca të rëndësishme mes institucioneve lidhur me tagrat/kompetencat e secilit institucion, dhe se si duhet të zhvillohet procesi.

Vlen të theksohet se me ndryshimet e fundit në ligjin 72/2022, si dhe në ligjin organik 45/2015, i ndryshuar, është parashikuar: *“Në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të personave të zhdukur dhe të ekzekutuar, në kuadër të Marrëveshjes së Këshillit të Ministrave me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 83/2018, Autoriteti ndërvepron me Ministrinë e Brendshme, për sa u takon instrumenteve ligjorë dhe institucioneve në varësi të saj”.*

Ky ndryshim zgjeron kompetencat dhe përgjegjësitë Autoritetit në këtë proces, duke i dhënë rol parësor bashkëpunimit me institucionet e tjera për zhvillimin e procedurës përkatëse.

**Bashkëpunime për të nxitur përpjekjet për identifikimin dhe gjetjen e trupave të personave të zhdukur gjatë Regjimit Komunist në Shqipëri.**

Me mbështetjen financiare të Fondacionit Konrad Adenauer dhe Prezencës së OSBE-së, u organizua tryeza teknike e Grupit të Punës për të nxitur përpjekjet për identifikimin dhe gjetjen e trupave të personave të zh-

dukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Tryeza mblodhi përfaqësues nga institucione shqiptare dhe ndërkombëtare, të përfshira në këtë proces, si Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991, Instituti i Mjekësisë Ligjore, dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

Prezenca e OSBE në Shqipëri ka organizuar disa tryeza teknike pune mbi identifikimin dhe rikuperimin e trupave të personave të zhdukur gjatë periudhës komunizmit, (4 Nëntor 2021, 22 shkurt 2022 dhe 6 Prill 2022, etj) në periudha të ndryshme kohore. Në të gjitha takimet e zhvilluara janë hedhur piketa se cili institucion/organ është përgjegjës për zbatimin e procedurave hap pas hapi dhe çfarë duhet të përmbajë në vetvete draft-VKM-ja përkatëse.

Në ndihmë dhe për qëllim të këtij procesi është marrë një ekspert i jashtëm, i financuar nga ICMP dhe KAS, i cili ka paraqitur një draft fillestar të diskutuar me përfaqësuesit e sipërcituar dhe të dakordësuar nga Autoriteti, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe ICMP-ja.

Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet, për qartësimin e fatit të të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti ka nënshkruar, më datë 03.02.2022, marrëveshjen nr. 165 prot., me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për, *“Garantimin dhe realizimin e një procesi të rregullt ligjor të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë periudhës së komunizmit”.*



## 5.4. HULUMTIMI SHKENCOR DHE EDUKIMI QYTETAR

### I. MBËSHTETJA SHKENCORE

Në zbatim të nenit 36, 37, 38 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 42 të Rregullores për “Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Autoriteti është përgjegjëse për:

- Informimin e studiuesve dhe mediave të interesuara për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimit e publikatave të tyre të kërkuesi, brenda afateve kohore të përcaktuara në akte nënligjore të dala në zbatim të ligjit organik 45/2015, i ndryshuar;
- Mbështetjen e veprimtarisë hulumtuese, të kërkimit shkencor me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimit e publikatave të dokumenteve.
- Në funksion të edukimit qytetar, me qëllim informimin e qytetarëve për dokumentet dhe veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit në tërësi, dhe me fokus brezat e rinj në veçanti, Autoriteti zhvillon veprimtari që ndihmojnë në formësimin e vetëdijes civile për rindërtimin e narrativës të së shkuarës komuniste, të mbështetur mbi kërkimin shkencor, brenda fushës së veprimtimit të këtij ligji.

Mbështetja shkencore bazohet kryesisht në përpunimin e kërkesave të studiuesve dhe medias për qëllime studimore dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit arkivor të kërkuar. Ky proces është kompleks sa u takon kërkesave studimore, kur për një kërkesë janë vënë në

dispozicion nga 1 deri në 400 dosje, për rrjedhojë merr kohën e vet, që nga kërkimi në arkiv, identifikimi i dosjeve, digjitalizimi, bërja e të dhënave të palexueshme për palët e treta, indeksimi i informacionit, përmbledhja e dosjes në tekste referuese, kontakti me familjarët dhe vënia në dispozicion studiuesve.

### Praktika të paraqitura gjatë vitit 2022

122 kërkesa studimore/mediatike janë paraqitur pranë Autoritetit gjatë vitit 2022, të cilat janë në faza të ndryshme të trajtimit. Nga këto kërkesa, që e kanë kaluar procesin e legjitimitit, 23 praktika janë të mbyllura. Materialet janë trajtuar dhe dokumentacioni është përpunuar e vënë në dispozicion të studiuesve/medias kërkuese të informacionit.

Për të gjitha dosjet e trajtuara gjatë kësaj periudhe, është bërë evidentim i të dhënave përkatëse për **49 dosje**, të cilat kanë kaluar procesin e anonimizimit, duke zbardhur dhe indeksuar informacionin mbi dosjet në **81 faqe** përmbledhje në total.

Ndër praktikat e trajtuara, gjithsej 122:

- 105 janë paraqitur nga studiues dhe institucione kërkimore;
- 17 nga media dhe institucione mediatike;
- 118 kërkesa për informim janë bërë nga studiues vendas;
- 4 nga studiues dhe institucione të huaja;

## Tregues informimi DMESHQ për vitin 2022

Viti	Në total	Të mbyllura	Në proces	Me të dhëna	Pa të dhëna	Kërkesa mediatike	Kërkesa studimore	Studues/instit./media vendase	Studues/instit./media huaj	Dosje të vëna në dispozicion	Fq. të anonimizuar	Fq. të trajtuara	Vendime të miratuara
2022	122	23	91	22	1	17	105	118	4	463	5.854	60.771	114

### Trajtimi i dokumenteve arkivore, anonimizimi, vënia në dispozicion

E drejta e çdo qytetari, studiuesi, medie për të shqyrtuar informacionin e ish-Sigurimit të Shtetit, duke mbrojtur privatësinë dhe identitetin e palëve të treta, po ashtu duke qenë transparentë, realizohet në zbatim të ligjit 45/2015, i ndryshuar.

Dokumentet arkivore, para se të vihen në dispozicion të kërkuësve shkencorë apo medias, kalojnë në procesin e anonimizimit, që bën të palexueshme të dhënat personale dhe sensitive. Gjatë vitit 2022 janë vënë në dispozicion 463 dosje, me rreth 60.771 faqe, ndër të cilat rreth 5.854 faqe kanë kaluar në proces anonimizimi .

## II. EDUKIM QYTETAR

### Projekte studimore dhe audio – vizuale

Krahas punës informuese, Autoriteti ka në themel të misionit të tij edhe edukimin e brezave mbi veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, përmes publikimeve në letër dhe online, (vendime, buletinë, raporte, botime të Autoritetit, broshura, etj.), organizimit të konferencave, ekspozitave, tryezave, vizitave, etj., kontaktit me

partnerë, homologë shqiptarë dhe ndërkombëtarë, projekteve institucionale dhe në bashkëpunim, kontakteve dhe punës paraprake për marrëveshjet ndërinstitucionale, çështjes së të zhdukurve, sa i takon dëshmime dhe organizimit të aktiviteteve lidhur me këtë, takimeve në terren, punës me dëshmitë në kuadër të projekteve, koordinimit me të tretët, etj.

- Gjatë vitit 2022, janë mbuluar veprimtari të shumta sa u takon aktiviteteve, të tilla si: takime, prezantim udhëzuesi, ceremoni, shfaqje teatrale e premierë filmi me fokus të shkuarën, si dhe shumë aktivitete të tjera;
- 2 tituj janë botuar: *“Emigracioni politik në Shqipëri në vitet 1944-1990”* dhe albumet me foto të përmbledhura nga aktivitetet e Autoritetit për vitet 2017, 2018, 2019;
- 288 postime të përditshme në rrjetet sociale dhe faqen zyrtare janë realizuar sipas datave të kujtesës dhe veprimtarive të institucionit;
- 3 video janë përgatitur nga dëshmitë e familjarëve të të zhdukurve marrë gjatë xhirimeve të dokumentarit *“Edhe muret kanë veshë”*;
- 3 video të dizenuara për dokumnetarin *“Fluturat”*, ligjëratën e Dr. Gjon Boriçi dhe monodramën *“Udha e Qumështit”*;

<sup>2</sup>Një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve të vëna në dispozicion, kanë qenë të anonimizuar më herët për kërkesa të studiuesve/medieve të mëparshëm.



## Aktivite, ekspozita, konferenca e takime të Autoritetit, të zhvilluara gjatë vitit 2022

Për qëllime të edukimit qytetar, në bazë të kalendarit të kujtesës dhe në kuadër të informimit e ndërgjegjësimit të shoqërisë, Autoriteti ka miratuara planin vjetor, i cili është zbatuar nga Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar. Për secilin aktivitet është koordinuar infrastruktura përkatëse, janë përgatitur ftesa, programe, shpërndarje dhe informacione e njoftime për shtyp, është transmetuar drejtpërdrejt, janë realizuar foto dhe video të dedikuara, për komunikim të zgjeruar me partnerët dhe publikun e interesuar:

### ❖ **Uran Kostreci – jeta, disidenca, vepra**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak, Arkivi Digjital Elbasan dhe Biblioteka Kombëtare, në bashkëpunim të ngushtë me miq e dashamirës të tij, organizuan aktivitetin:

**“Uran Kostreci jeta, disidenca, vepra”**, në mjediset e Teatrit “Skampa” në Elbasan, më 28 janar 2022.

Aktiviteti kishte për qëllim të sillte në vëmendje Uran Kostrecin, të prezantuar përmes dosjes së përndjekjes, aktivitetit politik, mendimit dhe fjalës së lirë, krijimtarisë letrare, kontributit si mësues dhe themelues i revistës “Liria”, po ashtu, ekspozimin e librave, shkrimeve, gazetave dhe dëshmisë së dhënë për projektin Edhe Muret kanë Veshë (EMKV).

Kostreci është një ndër figurat e rëndësishme të demokracisë dhe përballjes së saj me diktaturën dhe takimi për të hapi siparin e aktiviteve të Dialogut të Elbasanit.

### ❖ **Marrëveshje bashkëpunimi me Policinë e Shtetit, për gjetjen e të zhdukurve në diktaturë**

Më 3 shkurt 2022, Autoriteti dhe Policia e Shtetit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për garantimin e realizimit të një procesi të rregullt ligjor të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Marrëveshja me Policinë e Shtetit është e para që nënshkruhet në mbështetje të këtij ligji dhe do të pasohet nga marrëveshje me institucione të tjera të përfshira në proces, për të bashkërenduar punën me autoritetet përgjegjëse dhe mënyrën e mbrojtjes e të ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara, pas miratimit të VKM-së përkatëse.

### ❖ **Përvjetori i demonstratës antikomuniste në Kavajë**

Më 25 mars 2022, Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula dhe Anëtari z. Simon Mirakaj, morën pjesë në aktivitetin përkujtimor në nderim të demonstratës antikomuniste të 1990 në qytetin e Kavajës.

Thirrjet “Liri Demokraci”, “Poshtë diktatura”, “Poshtë dinastia”, gjatë ndeshjes “Besa”- “Partizani”, në stadiumin e qytetit, zbuluan se propaganda komuniste ishte fund e krye mashtrim.

### ❖ **“Diplomacia dhe Kultura”, në COD, Kryeministri**

Më 28 mars 2022, Kryetarja e Autoritetit Dr. Gentiana Sula mori pjesë në aktivitetin me temë: *“Pluralizmi fetar dhe sfidat politike në një vend kufitar; mes së shkuarës dhe të ardhmes”*, pjesë e ciklit *“Diplomacia dhe kultura”*, organizuar nga Qendra për Hapje dhe Dialog në Kryeministri. I ftuar, ambasadori i Selisë së Shenjtë, Shkëlqesia e Tij, imzot Luigi Bonazzi.

Tema për të cilën foli imzot Bonazzi ishte *“Pluralizmi fetar dhe sfidat politike në një vend kufitar; mes së shkuarës dhe së ardhmes”*. Në takim u diskutua mbi çështje të ndryshme të trajtuara në prezantimin e z. Bonazzi, si dhe mundësinë e ofrimit të një burse për të studiuar në arkivat e Vatikanit për një prej studentëve të interesuar, një mundësi kjo e veçantë studimi, e cila u krijua falë takimeve në COD.

#### ❖ **Përkujtimi i Meshës së Pashkëve, Tepelenë**

Më 2 prill, në ish-kampin e internimit, në Tepelenë, u përkujtua 70-vjetori i Meshës së Pashkëve të prillit 1952, të kremtuar nga pesë priftërinj katolikë, Dom Nikollë Mazreku, At Jak Gardini, At Viktor Volaj, At Zef Gilaj dhe At Ferdinand Pali.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, anëtarja, z. Simon Mirakaj, të mbijetuar të kampit e trashëgimtarë të tyre, si dhe besimtarë të ftuar nga Administratura Apostolike e Shqipërisë së Jugut morën pjesë në ceremoninë përkujtimore në kamp dhe kremtimin e Udhës së Kryqit, për të nderuar kujtimin e atyre që e humbën jetën në kampin me tela me gjemba të Tepelenës.

#### ❖ **Presidenti i Republikës së Shqipërisë dekoroi familjen Plaka**

Më 27 prill 2022, Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, nderoi, për merita të veçanta civile, 3 pjesëtarë të familjes Plaka, me propozim të Autoritetit.

E kaluara e familjes Plaka, në përballjen e saj me diktaturën dëshmon dinjitetin me të cilin anëtarët e saj sfiduan dhunën, terrorin dhe persekutimet, duke kaluar një kalvar të madh vuajtjesh, me 11 burra të dënuar politikisht me pushkatim, burgim, punë të detyruar dhe internim.

#### ❖ **Takim i Kryetares së Autoritetit me studentë të historisë**

Kryetarja e Autoritetit Dr. Gentiana Sula, më 6 maj 2022, prezantoi pranë Departamentit të Historisë në Universitetin e Tiranës, me prani të Prof. Dr. Valentina Duka dhe studentëve të historisë, veprimtarinë e Autoritetit dhe botimet, një pjesë e të cilave janë punuar në bashkëpunim me Institutin e Historisë.

#### ❖ **Vizitë e ish-Ambasadorit të OSBE-së në Tiranë, z. Berndt Borchardt**

Më 16 maj 2022, ish-Ambasadori i OSBE-së në Shqipëri z. Berndt Brochardt, i shoqëruar nga bashkëshortja, Barbara dhe Michael Strauven, zhvilluan një vizitë private në Autoritet. Kryetarja, znj. Gentiana Sula, i njohu me mjediset e reja të arkivit, me fond të organizuar dhe sistemuar tashmë, si dhe me zyrat e stafit. Po ashtu u diskutua për rolin e rëndësishëm që këto institucione kanë në krijimin e narrativës së të shkuarës dhe kujtesës.

Sipas Borchardt: *“Kultura e kujteses e lidhur me viktimat dhe me vuajtjet përforcon ndryshimin e rrefimit, që është i nevojshëm për të ndërtuar një shoqëri liberale pas shpërbërjes së një diktature.”*

#### ❖ **Stafi i Autoritetit pjesë e konferencës “Dritëhije”**

Pjesëmarrje e stafit të Autoritetit në konferencën „Dritëhije, e zhvilluar në Muzeun Kombëtar „Shtëpia me Gjethe“, më 23 maj 2022.

Përmes punimeve të prezantuara, fokusi u vendos tek trajtimi i historisë, ngjarjeve dhe njerëzve, me qëllimin e hedhjes dritë mbi regjimin e errët diktatorial.

### ❖ Ceremoni përkujtimore në nderim të viktimave dhe të dënuarve politikë të Revoltës së 22-majit të vitit 1984, e njohur si Revolta e Qafë-Barit

Më 23 maj 2022, u organizua ceremonia përkujtimore në nderim të viktimave dhe të dënuarve politikë të revoltës së 22 majit të vitit 1984, e njohur si revolta e Qafë-Barit.

*E nxitur nga kushtet e këqija dhe dhunës së ushtruar në burgun e Qafë-Barit, ajo nuk ishte vetëm revolte politike kundër sistemit, por edhe thirrje për liri, si shprehja me e lartë e dinjitetit njerëzor.*

Në aktivitetin e organizuar nga Instituti i të Përndjekurve Politikë, në bashkëpunim me Autoritetin, morën pjesë ish të burgosur politikë, familjarë të viktimave, përfaqësues të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme.

### ❖ Udha e kujtesës - Remembrance path

Në kuadër të projektit “Profilat e se shkuares: Lufta per liri dhe demokraci gjate regjimit te Hoxhes”, u realizua nga Universiteti i Tiranës, Universiteti “La Sapienza” i Romës, Fondazione di Storia “Onlus”, Shoqata “Zëri Qytetar” dhe Instituto di Storia dell’Europa Mediteranea (ISEM), ekspozita: “Udha e kujtesës – Remembrance path”.

Ekspozita me portrete të të dënuarve politikë me internim në ish-ndërmarrjen “28 Nëntori” prezantoi për të pranishmit dhe të rinjtë historinë e disa dekadave më parë në vend, duke zbuluar problemet e shoqërive diktatoriale, mohimin e të drejtave dhe lirisë për breza me radhë.

### ❖ Studentët e Fakultetit të Drejtësisë vizitë në Autoritet

Studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tira-

nës, të shoqëruar nga znj. Klesta Hysi, lektore pranë Departamentit të së Drejtës Publike dhe përgjegjëse për mbulimin e lëndës “Mbrotjtja e të Dhënave Personale” dhe znj. Iris Pekmezi, pedagoge e jashtme e lëndës, zhvilluan një vizitë në mjediset e Autoritetit në kuadër të zhvillimit të orëve praktike të lëndës,

Njohja mbi veprimtarinë e institucionit, organizimin e punës si dhe raportin që mbahet mes informimit/transparencës dhe mbrotjtjes së të dhënave personale ishin disa nga çështjet që u trajtuan gjatë këtij takimi.

Kryetarja e Autoritetit znj. Gentiana Sula i njohu studentët me ligjin Nr. 45/2015 i cili ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrotjtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit të pajtimit kombëtar.

### ❖ Kujtesa Evropiane 2022

Simpoziumi i 10-të i Kujtesës Evropiane u zhvillua më 1-3 qershor 2022, në Dublin. Qëllimi i organizimit ishte shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimit mes institucioneve të vendeve të ndryshme të cilat prezantojnë modelet më të mira në shërbim të pajtimit, paqes dhe ndërtimit të Kujtesës Evropiane.

Fokusi kryesor i simpoziumit ishte roli i pajtimit në kontekstin e konflikteve historike dhe bashkëkohore evropiane, të brendshme dhe ndërkombëtare, si dhe krijimi i një atmosfere bashkëpunimi dhe mirëkuptimi.

Shqipëria u përfaqësua nga ekipi i Autoritetit i kryesuar nga Kryetarja, Dr. Gentiana Sula, anëtare vëzhguese e Bordit Këshillues në ENRS-së.

### ❖ **Mbështetje mbi veprimtarinë e Autoritetit në zbardhjen e së shkuarës komuniste**

Më 16 qershor Ambasadori i Gjermanisë, z. Peter Zingraf, Ambasadorja e Francës në Shqipëri, znj. Elisabeth Barsacq dhe kryetarja e Komisionit të ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë, znj. Klotilda Bushka, vizituan Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pak ditë para ceremonisë zyrtare të përrurimit të mjediseve të reja të institucionit.

Ambasadorët u pritën nga anëtarët e Autoritetit, të cilët i njohën me punën e institucionit, sfidat e tashme e të ardhme, dhe me hapësirat e reja, ku zhvillon veprimtarinë Autoriteti.

Gjatë vizitës, znj. Gentiana Sula i njohu përfaqësuesit diplomatikë me punën e bërë që në themelimin e institucionit, vendimi i parë për të cilin ishte caktimi i ndërtesës së Autoritetit.

### ❖ **Takimi i përvitshëm i Rrjetit Europian të Arkivave të ish-Policive Sekrete**

Më 28-30 qershor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit mori pjesë në takimin e përvitshëm të Rrjetit Europian të Arkivave të ish-Policive Sekrete, që këtë vit u zhvillua në Budapest.

Punimet u organizuan nga Arkivi Historik i Shërbimeve Sekrete Hungareze (ABTL), në cilësinë e mbajtësit të Presidencës së radhës së Rrjetit. Morën pjesë përfaqësues të institucioneve anëtare me të drejta të plota në Rrjet, nga Shqipëria, Bullgaria, Republika Çeke, Gjermania, Hungaria, Polonia, Rumania, Sllovakia, si dhe përfaqësues të institucioneve anëtare me të drejta vëzhguesi, nga Estonia, Latvia, Lituania dhe Sllovenia.

Presidentit të Arkivave Federale të Gjermanisë, Prof. Dr. Michael Hollmann. Z. Bendegüz bëri njoftimin se pas

Gjermanisë, sipas dokumentit të themelimit të Rrjetit, për periudhën 2023-2024 presidenca e Rrjetit do t'i kalojë Shqipërisë.

### ❖ **Një ditë “me” poetët Vilson Blloshmi dhe Genc Leka, në Bërzeshtë-Librashd**

Më 17 korrik u organizua në Bërzeshtë të Librazhdit, aktiviteti me titull: “Një ditë ‘me’ poetët Vilson Blloshmi dhe Genc Leka”. Autoriteti u përfaqësua në këtë aktivitet nga Z. Skënder Vrioni, Anëtar i Autoritetit dhe Z. Selami Zalli, Drejtor i Informacionit.

Edhe në këtë simpozium u fol dhe u trajtua jeta, vepra dhe krijimtaria letrare e martirëve.

### ❖ **Përkujtohet 73-vjetori i masakrës së Qafës së Valmirit**

Autoriteti përkujtoi në Shpal të Mirditës, 17 gushtin e vitit 1949, ditën kur u ekzekutua me vendim gjykate, masakra ndaj 14 të pafajshmëve.

Autoriteti u përfaqësua nga anëtarët: znj. Gentiana Sula, z. Gjergj Marku dhe z. Skënder Vrioni, në një organizim përkujtimor të shoqatës “14 Martirët e Demokracisë”, me praninë përfaqësuesve të ISKK-së dhe të z. Ethem Fezollari, Kryetar i Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë, z. Kolë Nikolli, z. Filip Gjomarku dhe z. Preng Gjergj Beleshi, mes familjarëve të të ekzekutuarve pa faj, të gjithë të dënuar për disa breza.

Dom Gjergj Meta, Ipeshkvi i Rrëshenit, mori pjesë në ceremoninë përkujtimore pranë varrit të përbashkët të 14 të ekzekutuarve dhe drejtoi meshën në kishën e Shpalit, ceremoni që çdo vit kthen vëmendjen në një plagë të pambyllur të familjeve, komunitetit dhe shoqërisë, dënimit kolektiv të të pafajshmëve për vrasjen e deputetit të Kuvendit Popullor të kohës, Bardhok Biba.

## ❖ **Në Tepelenë në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Totalitarizmit**

Në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Totalitarizmit, më 23 gusht, si çdo vit, Autoriteti zhvilloi pelegrinazhin e dhimbjes në kampin e Tepelenës, në kujtim të njerëzve pa faj që vuajtën në ish-kampin me tela me gjemba ose humbën jetën atje.

Memoriali i vendosur në ish - Kampin e Tepelenës u realizua nga Autoriteti dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, në bashkëpunim me Bashkinë e Tepelenës, në kuadër të projektit ICMP-AIDSSH *“Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit të komunizëm”*, të mbështetur nga BE dhe Ambasada Zvicerane.

## ❖ **Vizitë në memorialin e Vloçishtit**

Ekipi i Autoritetit, familjarë të të dënuarve, partnerë dhe përfaqësues të komunitetit, më 23 gusht, zhvilluan një ceremoni nderimi pranë Memorialit të vendosur në Vloçisht.

Autoriteti dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, në bashkëpunim me Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak të Maliqit, në mbyllje të projektit ICMP-AIDSSH *“Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit të komunizëm”*, të mbështetur nga BE dhe Ambasada Zvicerane, përruruan më 17 shkurt 2022 ekspozitën e përhershme informuese mbi ish-kampin e punës në Maliq.

## ❖ **Premiera “Fluturat”, të internuarat në Gradishtë e Savër, dje dhe sot**

Dokumentari *“Fluturat”*, i regjisorit Bujar Alimani, u shfaq premierë në kinema “Millennium”, më 30 gusht, Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, duke bërë bashkë në sallë qindra të mbijetuar, familjarë, për-

faqësues të institucioneve homologe dhe partnere të Autoritetit, përfaqësues të komunitetit artistik në vend, grupe të interesit, përfaqësues të pushtetit qendror e vendor, trupit diplomatik e medias. *“Fluturat”* ndjek përmes një spiraleje gjithëpërfshirëse historitë e 21 vajzave që u mbijetuan internimeve me breza në Gradishtë e Savër të Lushnjës.

## ❖ **Autoriteti prezanton punën e tij dokumentare në Javën e Kulturës Suedeze në Shkodër**

Më datë 13 shtator, Autoriteti mori pjesë në një aktivitetet të organizuar nga Ambasada Suedeze, në kuadër të javës kulturore suedeze, në qytetin e Shkodrës, i cili kishte si qëllim prezantimin e partnerëve lokalë dhe qendrorë të mbështetur me fonde të Qeverisë Suedeze për realizimin e veprimtarisë së tyre.

Ambasadorja e Suedisë në Shqipëri, Znj. Elsa Håstad, Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Bardh Spahia, Prefektja e qytetit Shkodër znj. Majlinda Angoni dhe të ftuar të tjerë të ambasadës vizituan, mes të tjerash, edhe stendën e Autoritetit me botimet shkencore dhe buletinët periodikë, në të cilët përshkruhet veprimtaria e Autoritetit në vite, aktet zyrtare, aktivitetet në kuadër të kujtesës, etj.

## ❖ **Vizitë në ekspozitën e hapur “Mom, i don’t want war!”**

Më datë 16 shtator, me ftesë të Ambasadores së Polonisë, Znj. Monika Zuchniak-Pazdan dhe Ambasadorit të Ukrainës në Shqipëri, Z. Volodymyr Shkurov, Kryetarja në detyrë, Znj. Gentiana Sula dhe stafi i Autoritetit, vizituan ekspozitën në sheshin “Skënderbej”, *“Mom, I don’t want war!”*, në të cilën ishin mbledhur dhe ekspozuar vizatime të fëmijëve ukrainas që përshkruajnë pushtimin e vazhdueshëm rus dhe vizatimet e fëmijëve polakë të pas Luftës së Dytë Botërore.

#### ❖ **Stafi i Autoritetit, pjesë e konferencës “Dritëhije”**

Më 23 maj, në Muzeun Kombëtar „Shtëpia me Gjethe“, u zhvillua konferenca „Dritëhije“, e cila kishte si qëllim hedhjen dritë mbi regjimin e errët diktatorial, duke u fokusuar tek trajtimi i historisë, ngjarjeve dhe njerëzve.

Specialistë të Autoritetit kontribuan në këtë konferencë me studimet e tyre.

#### ❖ **Pjesëmarrje në konferencën e organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si anëtar i Bordit Këshillimor për projektin “Ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve dhe profesionistëve shqiptarë në fushën e drejtësisë tranzicionale” zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, është ftuar, herë pas here, të marrë pjesë në konferencat e organizuara nga Prezenca në vende të ndryshme të Shqipërisë për prezantimin e punimeve të Masterit Ndërdisiplinor në Drejtësinë Tranzitore në Shqipëri, në kuadrin social, ligjor dhe historik.

#### ❖ **Vizitë studimore në Kroaci**

Më 27 shtator Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi një vizitë studimore, në Kroaci, për përfaqësues të institucioneve kryesore në këtë fushë, si Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Policia Shkencore. Përvoja e gjerë e Kroacisë në hetimin dhe gjykimin e rasteve të zhdukjeve me forcë mund t’i ndihmojë autoritetet shqiptare në çuarjen përpara të punës për identifikimin dhe gjetjen e eshtrave të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist.

#### ❖ **Takim i Autoritetit me Shoqatën e ish-të Përndjekurve Politikë të qytetit të Vlorës**

Më 11 tetor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi, në qytetin e Vlorës, një takim me shoqatën e ish-të Përndjekurve Politikë të qytetit.

Hapja e dokumenteve në arkivat e Autoritetit, zbardhja e dëshmimeve lokale mbi vuajtjet e ish të dënuarve politikë, evidentimi dhe gjetja e të zhdukurve, kthimi në qendra të vizitueshme për të rinjtë e shkollave, të vendbanimeve të të internuarve dhe kampeve të ish-të dënuarve politikë, ishin temat ku u përqendrua biseda gjatë këtij takimi.

#### ❖ **Aktivitet i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, zhvilluar në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër**

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi një takim në Universitetin “Luigj Gurakuqi” mbi të kaluarën komuniste dhe Drejtësinë Tranzitore në qytetin e Shkodrës më 14 tetor.

Shefi i departamentit për të drejtat e njeriut i OSBE-së në Shqipëri, z. Cailean Maclean, referoi se studimet e larta mbi të kaluarën komuniste kanë informacion të kufizuar, ndërsa u shpreh se qeveria duhet të luajë rolin e saj që brezat e rinj të jenë të ndërgjegjësuar dhe të informuar saktësisht mbi komunizmin. Ai tha se është sfida e madhe përse i përket studimeve akademike lidhur me të drejtat e njeriut gjatë të shkuarës komuniste, ndërsa hulumtimet akademike vazhdojnë të kryhen në Shqipëri mbi këtë temë, por studimi i metodave të tyre lë shumë vend për përmirësim. Në mënyrë që të thellohet më shumë kjo njohuri mbi drejtësinë tranzitore dhe për të angazhuar e përfshirë më shumë të rinjtë. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka mundësuar krijimin



e një qendre të specializuar për drejtësinë tranzitore në Universitetin e Tiranës në një master shkencor dhe po bën këto takime për të shtrirë këtë mastër edhe në universite të tjera.

❖ **Konferenca e 12-të Ndërkombëtare “Gjenealogjia e memorjes: Historia dhe kujtesa në marrdhëniet ndërkombëtare”**

Në datat 26-28 tetor u zhvillua, në Varshavë, Poloni, Konferenca e 12-të ndërkombëtare “Gjenealogjia e memorjes: Historia dhe kujtesa në marrdhëniet ndërkombëtare”, organizuar nga Rrjeti Evropian i Kujtesës dhe Solidaritetit.

Gjatë tri ditëve të konferencës, u trajtuan tema të cilat lidhen me memorien në nivel ndërkombëtar, tipologjitë e ndryshme të saj, për dëshmitë gojore, përkufizimin e memories, aktorët dhe veprimet që duhen ndërmarrë, u trajtuan vendet e kujtesës, memoria politike, historia dhe marrdhëniet ndërkombëtare etj. Temat u trajtuan nga ekspertë të fushës, të universiteteve e institucioneve të vendeve të ndryshme, me profesionalizëm.

Bashkëpunëtorë në këtë organizim ishin edhe: Qendra për Studime e Europës Lindore dhe Ndërkombëtare, Zois, Berlin; Qendra për Studimin e Paqes dhe Konfliktit, Seton Hall University; Kolegji Evropian, Natolin; Shkolla e Oksfordit për Studime Ndërkombëtare dhe Lokale; Universiteti i Varshavës, Fakulteti i Sociologjisë.

❖ **Promovimi i librit- “Njeriu perballe perbindeshit. Dosje te pafundeme te Musa Sines –dokumente dhe refleksione”, nga Jozef Radi**

Më 15 nëntor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit organizoi diskutimin mbi librin e autorit Jozef Radi, “Njeriu perballe perbindeshit. Dosje te pafundeme te Musa Sines –dokumente dhe ref-

leksione”, një libër i ndërtuar mbi dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, nga arkivi i Autoritetit.

Biseda mbi librin, ngjarjet, jeta në burg, internim dhe më pas në liri e një prej mijëra viktimave të diktaturës së proletarietit, trajtimi i dokumenteve të Sigurimit jo vetëm nëpërmjet dokumentimit por edhe analizës sintetizuese, përfshiu në debat studiues të historisë, përfaqësues të Autoritetit, miq e bashkëvuajtës të autorit.

❖ **Takim i Kryetares së Autoritetit me studentë, në kuadër të aktivitetit “muza ime”, kushtuar kujtimit të Musine Kokalarit**

Kryetarja e Autoritetit për Informim me Dokumente të Ish-Sigurimit të Shtetit, znj. Gentiana Sula, zhvilloi një takim me studentë dhe të rinj nga të gjithë trevat e Shqipërisë, në kuadër të aktivitetit “Muza ime”, kushtuar kujtimit të Musine Kokalarit, organizuar nga CHWB Albania (Cultural Heritage Without Border Albania), më 21 nëntor, në qytetin e Gjirokastrës.

Në qendër të këtij takimi ishte biseda rreth figurës së Musine Kokalarit, politikane dhe qëndrestare që regjimi komunist e burgosi për 16 vjet dhe e internoi për 22 të tjera. Në fjalën e saj, Kryetarja e Autoritetit. Znj. Sula e konsideroi Musine Kokalarin si ikonën e disidencës shqiptare, mësimet dhe mendimi politik i së cilës ende mbetet sot për t’u eksploruar nga studiuesit dhe të rinjtë.

❖ **“Tirana nën kontrollin e pushtetit komunist - tatimet, konfiskimet, internimet, rezistenca ne fillimet e regjimit totalitar 1945-1949”, nga Dr. Gjon Boriçi**

Në kuadër të projektit „Tirana në sytë e Sigurimit të Shtetit“, me fokus hedhjen dritë mbi historinë gjysëmshkullore të Tiranës kryeqytet në diktaturë, nëpërmjet studimit e hulumtimit të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit,

në ambjentet e Muzeut Historik Kombëtar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në datën 23 nëntor, organizoi ligjëratorën me titull: *“Tirana nën kontrollin e pushtetit komunist – tatimet, konfiskimet, internimet, rezistenca në fillimet e regjimit totalitar 1945-1949”*, mbajtur nga Dr. Gjon Boriçi.

#### ❖ **Shfaqja e monodramës “Udha e qumështit” në ambjentet e Autoritetit**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të datës 8 dhjetor, Ditës Kombëtare të Rinisë, si dhe në përmbushje të misionit të tij, për krijimin e një platforme gjithëpërfshirëse për kuptimin e së shkuarës komuniste në Shqipëri, organizoi më 7 dhjetor, në ambientet e Autoritetit, për publikun, partnerët, ish-të përndjekurit politikë, studentë e miq të Autoritetit, shfaqjen e monodramës „*Udha e qumështit*“, vepër e ndërtuar mbi një histori tipike, të vërtetë, të shoqërisë shqiptare nën diktaturë, kur një gjest i thjeshtë shkakton pasoja të rënda për jetën e qenies njerëzore, me regjisor Armando Borën dhe interpretim të aktores Eglja Ceno.

#### ❖ **Kontributi i arkivave në Srebrenicë**

Kontributi i arkivave për drejtësinë tranzicionale zhvilloi takimin ndërkombëtar të ekspertëve, me titull: *“Kontributi i arkivave për drejtësinë tranzicionale dhe më gjerë”*, në datat 8 dhe 9 dhjetor 2022 në Qendrën Memoriale të Srebrenicës, Potoçari (Bosnjë dhe Hercegovinë). Ky takim ndërkombëtar i ekspertëve ishte një kombinim i mirë i përvojës shkencore, akademike rreth rolit që kanë arkivat në fushën e kujtesës, drejtësisë tranzicionale si dhe njohjes me vendngjarjen, vende të kujtesës të ngritura në kujtim të gjenocidi që ndodhi në Srebrenicë në korrik të vitit 1995.

#### ❖ **Vizitë disaditore në Bruksel, në kuadër të misionit të hedhjes dritë mbi të shkuarën komuniste të Shqipërisë**

Në datat 13-14 dhjetor, Autoriteti zhvilloi një vizitë disaditore në Bruksel, për takime me Komitetit Shqiptar në Belgjikë, përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Europian e më tej në organizimin për shfaqjen e Filmit “Edhe muret kanë veshë”, një prodhim i Autoritetit për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

Kjo vizitë hodhi dritë mbi të shkuarën komuniste të vendit tonë dhe krijimin e urave lidhëse me komunitetin shqiptar që ndodhet në Belgjikë.

Në këtë vizitë Autoriteti u prit nga Ambasadorja e Shqipërisë në Bruksel, znj. Suela Janina, me të cilën ndau një bisedë rreth punës që kryen Autoriteti në drejtim të zbardhjes së të shkuarës komuniste dhe nevojës për ndërtimin e një narrative të re në fushën e kujtesës kolektive, me qëllim njohjen e vuajtjeve, internimeve dhe pushkatimeve të mijëra shqiptarëve në diktaturë.

Po ashtu, ekipi i Autoritetit, shoqëruar nga deputetët znj. Dhurata Çupi Tyli dhe z. Bledion Nallbati, në kujdesin e Ambasadores së Shqipërisë në Bruksel znj. Suela Janina finalizuan një takim të rëndësishëm me përfaqësues të Komisionit Europian, z. Alberto Cammarta, kreu i njësisë për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe z. Vincent Rey, Drejtues i Integrimin Europian për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerimin e Negociatave me fqinjët, me të cilët u diskutua rreth rolit që ka Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në ecjen përpara të demokracisë në vend dhe në integrimin evropian.

#### ❖ **Ekspozita virtuale “Sigurimi me fjalët e veta” - prezantohet libri me dëshmi të familjarëve të të zhdukurve në diktaturë**



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit prezantoi librin me dëshmi për të zhdukurit dhe ekspozitën virtuale “Sigurimi në fjalët e veta”, në mjediset e reja, pranë garnizonit Skënderbej, 24 shkurt 2022.

Ceremonia përmbylli projektin ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit të komunizëm”, të mbështetur nga BE dhe Ambasada Zvicerane.

Të gjitha produktet e rëndësishme të këtij projekti, që e ndikoi ndjeshëm debatin shoqëror mbi të zhdukurit në komunizëm u prezantuan në aktivitet, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Të pranishëm në ceremoni ishin familjarë të të pagjeturve të komunizmit, përfaqësues të shoqatave të të përndjekurve dhe kujtesës, përfaqësues të institucioneve, ICMP për Shqipërinë, të grupeve të interesit, trupit diplomatik, aktorë të shoqërisë civile, gazetarë dhe të rinj.

### III. AUTORITETI NË MEDIA

#### ❖ Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, e ftuar në studion e emisionit: “Opinion”

Më datë 8 shtator, Znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit, ishte e ftuar në studion e emisionit: “Opinion” të televizionit Klan për t’iu përgjigjur pyetjeve, që drejtuesi i emisionit, z. Blendi Fevziu, kishte përgatitur për të. Pyetjet ishin rreth ligjit, funksionimit dhe marrdhënies së Autoritetit me qytetarët e studiuesit, si dhe pengesat ligjore që ka hasur Autoriteti gjatë zbatimit të ligjit nga komisionet Mezini dhe Bezhani.

Në linkun e mëposhtëm është intervista e plotë e Znj. Gentiana Sula për emisionin “Opinion”.

<https://www.youtube.com/watch?v=o2xzgplWwVQ>

#### ❖ Intervista e Kryetares së Autoritetit në Top Channel, në breaking top news

Më datë 9 shtator Znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit, ishte e ftuar në Breaking Top News, Top Channel, ku ndër të tjera, theksoi se Partitë Politike nuk sjellin listat për transparencë. Në linkun e mëposhtëm mund të ndiqni intervistën e plotë. <https://top-channel.tv/.../gentiana-sula-zbulon-se.../> [Gentiana Sula Faqja Zyrtare](#)

#### ❖ Kronikë e Top Channel në ambjentet e Autoritetit

Më 18 tetor në ambjentet e Autoritetit, gazetarët e Top Channel zhvilluan një kronikë.

Në dosjet e policisë sekrete famëkeqe të Shqipërisë për të ashtëquajturit “armiqtë të shtetit Enver Hoxha dhe Sigurimit të frikshëm të Shtetit, kishte mbi 10,000 informatorë dhe ende ka shumë bashkëpunëtorë - thotë AFP.

“Duke parë dosjet, ti shikon edhe krahasuar me vendet e tjera, se dhuna politike është ekstreme, dënimi kapital është shumë i përdorur. Janë afërsisht 5500 të dënuar në proceset e asaj kohe, me vdekje”. - Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH.

[Top Channel AFP](#)

#### ❖ Intervistë e Kryetares në detyrë të Autoritetit me gazetaren znj. Fatmira Nikolla, mbi ndryshimet ligjore

Më 27 tetor, në ambjentet e Autoritetit, u zhvillua intervista ndërmjet Kryetares në detyrë Znj. Gentiana Sula dhe gazetares së News 24-ës znj. Fatmira Nikolli, mbi ndryshimet ligjore që u miratuan në Parlament. Ndër të tjera, Znj.Sula shpjegoi se: “Tashmë hiqet neni që pengonte vendimet e komisioneve Mezini-Bezhani. Sa i takon figurave të verifikuara, para ndryshimeve ligjore, ne do të duhet të marrim vendime për to. Vendimet i

merr organi kolegjal i Autoritetit të Dosjeve. Në linkun e mëposhtëm mund të ndiqni kronikën e plotë. <https://https://youtu.be/jXDo73legQY>

#### ❖ “Opinion” në Autoritet

Më 27 tetor u transmetua në televizionin Klan, në emisionin “Opinion”, vizita që z. Blendi Fevziu zhvilloi në ambjentet e Autoritetit, duke realizuar kronikën me titull, “Ku ruhen e si janë dosjet e sigurimit” Në linkun e mëposhtëm është kronika e plotë:

[Opinion – Ku ruhen dhe si janë dosjet e sigurimit! - YouTube](#)

#### IV. PËRDITËSIMI, PËRMIRËSIMI DHE MIRËMBAJTJA E FAQEVE TË AUTORITETIT

Autoriteti, edhe përgjatë vitit 2021, ka mbajtur marrëdhënie dhe komunikim institucional me publikun dhe të tretët.

Për çdo muaj përgatit një kalendar paraprak publikimesh, që ndahet mes anëtarëve dhe të gjitha drejtorive të institucionit, për pasurimin me informacion të plotë e të gjithanshëm të faqes së institucionit. Në kushtet e pandemisë, Autoriteti e ka rritur praninë dhe ndërveprimin online, sa i takon komunikimit me publikun, grupet e interesit, fusha të kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, pasqyrimin të marrëdhënieve me institucionet, projekteve të AIDSSH, hapave të punës për veprimtaritë e ndryshme të institucionit, e paraqitur ditë pas dite në hulumtimet, albumet, përmbledhjet e videove, të vendimeve, buletinëve, si dhe njoftimet përkatëse për shtyp, të punuara nga kjo drejtori.

Paralelisht, në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse në Autoritet, është përditësuar faqja zyrtare [www.audoritetidosjeve.gov.al](http://www.audoritetidosjeve.gov.al), me përmbajtje dhe foto; po ashtu,

janë publikuar online të gjitha botimet e Autoritetit, si burime serioze mbi të shkuarën, për të rinjtë e të interesuarit e tjerë.

Është dhënë përparësi komunikimit me individët, studiuesit, institucionet, të interesuarit. Gradualisht, është rritur puna e përditshme online me informacion mbi dosje, ngjarje dhe figura historike, po ashtu, me njohje të hulumtimeve mbi to, në faqet zyrtare në rrjet të Autoritetit, sipas kalendarit të kujtesës.

Për këtë është punuar, si për përmbajtjen, ashtu edhe anën vizive, duke pasqyruar projektet në mediat sociale të Autoritetit. Janë përditësuar dhe pasuruar në mënyrë sistematike, për ndërveprim sa më të mirë me ndjekësit, me postime të përditshme, hulumtime dhe shpërndarje të informacionit, të gjitha mediat online. Në këtë mënyrë është mbajtur kontakt edhe me gazetarët e interesuar.

Faqja [www.dosjet.gov.al](http://www.dosjet.gov.al), e lidhur me të tri faqet e Autoritetit, është shpërndarë gjerësisht përmes studimeve dhe informacionit të trajtuar.

Janë krijuar video informuese mbi veprimtarinë e Autoritetit, janë përgatitur pjesë të veçanta nga intervistat e dhëna Autoritetit, janë përmbledhur aktivitete dhe shpërndarë gjerësisht kronika. Të gjitha janë publikuar në faqet zyrtare (info më sipër).

Youtube: [Autoriteti i Dosjeve](#)

- **Youtube:** Autoriteti i Dosjeve
- **Issuu:** <https://issuu.com/aidssh>
- **Facebook:**  
<https://www.facebook.com/AutoritetiDosjeve/>
- **Instagram:** Autoriteti Dosjeve (AIDSSH)
- **Twitter:** <https://www.twitter.com/aidssh>

## V. BOTIME

Gjatë vitit 2022 ka vijuar puna për përgatitjen për botim dhe ndjekjen e të gjitha proceseve të librave me tematikë të dedikuar, që përmbajnë materiale të dosjeve të Sigurimit dhe trajtojnë në mënyrë komplekse figurat, personalitetet apo ngjarjet historike. Po ashtu, edhe për versionet online të cilat publikohen në faqen ISSUU të Autoritetit.

Më poshtë tabela e plotë e botimeve të Autoritetit, të punuara dhe të finalizuara gjatë vitit 2022:

- ✓ Broshura “Zhdukur” me materiale të ekspozitës “Sigurimi në fjalët e veta”;
- ✓ Udhërrëfyese për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunistit shqip, anglisht;
- ✓ Librat “Të zhdukur në diktaturë, dëshmojnë familjarët”, në shqip dhe “Disappeared under dictatorship, testimonies of family members”, anglisht;
- ✓ Raporti vjetor 2021;
- ✓ Ekspozita virtuale, e lidhur me faqen zyrtare të institucionit;
- ✓ Botim i buletinëve 1, 2, 3, 4, 5, 6, viti 2020;
- ✓ Dosjet indeks, logo;
- ✓ Ribotim i “Profile të Armikut të Popullit në diktaturë”;
- ✓ Ribotim “Deputetë për Deputetë”;
- ✓ Ribotim “Të mohuar nga regjimi”;
- ✓ Përmbledhja dhe organizimi i materialeve për botim, dhe përzgjedhja e modeleve për faqosje për librin mbi “Emigracionin Politik”;
- ✓ Përmbledhja dhe organizimi i vendimeve për publikim në web;
- ✓ Përgatitja e draftmarrëveshjes kuadër për botimet e vitit 2022-2023;
- ✓ Përgatitja për publikim në web i buletinëve 5, 6, viti 2021;
- ✓ Përgatitja për publikim në web i buletinëve 1, 2, 3, 4, 5, 6, viti 2022;
- ✓ Realizimi i foto-albumeve 2017-2019;
- ✓ Për mundësimin e sa më sipër është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me studiuesit për dorëzim materialelesh për botim;
- ✓ Komunikim i vazhdueshëm me shtëpinë botuese “Onufri” dhe është koordinuar puna me stafin për realizimin e foto-albumeve;

Titujt janë publikuar nga Autoriteti të shpërndarë në të gjithë vendin dhe të sugjeruar gjerësisht online, në faqen e tij zyrtare, [Botime AIDSSH – Autoriteti i Dosjeve \(autoritetidosjeve.gov.al\)](#) dhe në platformën ISSUU, <https://issuu.com/aidssh>, e kanë rritur performancën e institucionit në peizazhin akademik në vend dhe jashtë tij, nëpërmjet burimeve serioze mbi të shkuarën.

<b>MBËSHTETJA SHKENCORE</b>	<b>EDUKIMI QYTETAR</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>√ 120 kërkesa në total</li> <li>√ 103 kërkesa studimore</li> <li>√ 17 kërkesa mediatike</li> <li>√ 643 dosje të vëna në dispozicion</li> <li>√ 74.175 faqe të vëna në dispozicion</li> <li>√ 5.854 faqe të anonimizuara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>√ 56 botime në letër</li> <li>√ 59 botime online</li> <li>√ 300 publikime në media sociale dhe tekste për faqen zyrtare</li> <li>√ 22 video për 19 dëshmi të familjarëve të të zhdukurve</li> <li>√ 14 orë intervista</li> <li>√ faqe të transkriptuara</li> <li>√ 33 aktivitete në vit, 8 online, 23 në terren, 3 jashtë vendit</li> <li>√ 35 njoftime për shtyp</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>√ 81 faqe përmbledhje të dosjeve të lexuara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>√ 180 faqe kalendar për komunikimin në mediat sociale, me informacione mbi dosje, data përkujtimore, veprimtari të Autoritetit dhe bashkëpunime me partnerët</li> <li>√ 50 video të përgatitura për aktivitete dhe komunikim publik online,</li> <li>√ Kartolina 2022 dhe shpërndarja e zgjeruar e saj</li> </ul>

Në bashkëpunim me partnerë, mbështetur në hulumtim shkencor, Autoriteti ka vijuar publikimin e botimeve, duke rritur burimet për të shkuarën dhe përmbushur misionin e vet në edukimin qytetar për demokraci.

### 5.5. SIGURIA DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK

- ❖ Gjatë të gjithë vitit, Autoriteti, përmes Drejtorisë së Sigurisë, ka monitoruar sigurinë fizike, zbatimin e urdhrave të hartuar për vendosjen e parametrave të kërkuar të sigurisë për informacionin e klasifikuar. Gjithashtu, në çdo rast, janë mbajtur kontakte me Ministrinë e

Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorinë për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Repartin Ushtarak Nr. 6630, për lehtësimin e hyrje-daljeve të vizitorëve, aplikantëve dhe personave të ftuar në Autoritet. Gjatë eventeve të mbajtura në ambjentet e Autoritetit si: prezantimi i librit me dëshmi të familjarëve të të zhdukurve në diktaturë dhe ekspozita virtuale “*Sigurimi në fjalët e veta*”, ceremonia e pëdurimit të ndërtesës së Autoritetit, promovimi i librit “*Njeriu përballë përbindëshit*”, etj, është asistuar në lehtësimin e hyrje-daljeve të të ftuarve si dhe sigurinë në çdo moment tëurvejuar nga kamerat.

- ❖ Pas zhvendosjes së Autoritetit në ambientet e reja pranë Ministrisë së Mbrojtjes, brenda Garnizonit “Skënderbej”, janë marrë masat e transferimit të dokumenteve në zotërim te Autoritetit nga institucionet në bashkëpunim i SHISH dhe IPQP. Gjatë periudhës shkurt-mars 2022, është bërë i mundur transferimi fizik i dokumenteve nga arkivi pranë SHISH, drejt Autoritetit dhe gjatë periudhës shtator-tetor 2022, u bë transferimi fizik i dokumenteve nga godina e Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, e cila ndodhet pranë Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, në godinën e re të Autoritetit. Përgjatë këtyre transferimeve është mbajtur vazhdimisht kontakt me Policinë e Shtetit për shoqërimin e sigurt të dokumenteve të klasifikuara.
- ❖ Është monitoruar gjatë gjithë vitit zbatimi i urdhrave të hartuar për vendosjen e parametrave të kërkuar të sigurisë për informacionin e klasifikuar. Në zbatim të Urdhrit “Për zonat e sigurisë dhe plani i masave”, Urdhrit “Për administrimin e çelsave”, janë kryer procedurat e prokurimit për blerjen e kasafortave si dhe janë vendosur çelsat sipas rregullores në kasaforta. Gjithashtu, në zbatim të Urdhrit për regjimin e hyrje-daljeve në Autoritet, janë konfiguruar dhe shpërndarë kartat e aksesit për punonjësit e Autoritetit. Është mbikqyrur instalimi dhe konfigurimi i sistemit të shuajtjes së zjarrit si dhe është mbikqyrur instalimi dhe konfigurimi i sistemit të alarmit.
- ❖ Vazhdon të bëhet mirëmbajtja dhe përditësimi me materiale, informacione, dokumente, njoftime, etj. Në këtë kuadër punohet jo vetëm për mirëmbajtjen e faqes zyrtare të Autoritetit: [www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al), por edhe për përditësimin dhe editimin e rubrikave, përditësimin me informacione, njoftime për shtyp, konferenca shkencore, vendimet e Autoritetit, deklasifikimet, publikimet e vendeve të lira të punës etj. Kjo transparencë ndihmon në mirëinformimin e publikut, me qëllim arritjen tek një numër sa më i madh qytetarësh-përdorues të faqeve online për marrjen e një informacioni sa më të plotë, si dhe për sensibilizimin e tyre për t’u bërë pjesë e këtij procesi. Publikimet janë kryer dhe në ISSUU për lehtësimin e aksesimit të botimeve të Autoritetit nga përdoruesit. Për këto faqe cdo muaj janë mbajtur edhe statistika shikueshmerie dhe është vënë re çdo muaj rritja e shikueshmërisë nga publiku.
- ❖ Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fushën e informacionit të klasifikuar dhe në zbatim të VKM-së nr. 542 datë 25.07.2019 dhe VKM nr. 312 datë 16.03.2011, informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror” i cili shkëmbehet nëpërmjet rrjeteve informative, kryhet kur pajisjet janë të certifikuar përshtatshëmrisht. Është hartuar dokumentacioni për procedurat e operimit të sigurt dhe koncepti i operimit të sistemit me qëllim inicimin e procesit të akreditimit të sistemit, si dhe janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me DSIK.
- ❖ Sektori i zhvillimit teknologjik, në mënyrë permanente ka për detyrë të mirëmbajë kompjuterët e instaluar pranë çdo punonjësi dhe të ndërhyje me efektivitet për rregullimin e defekteve. I njëjti proces pune ndiqet dhe me printerët, skanerët, skanerët e avancuar, skaner microfilm, lexues microfilm, etj. Në funksion

të përmirësimit cilësor të punës dhe në konsiderim të futjes në përdorim të teknologjive të reja, duhen instaluar programe në kompjuter sipas kërkesave të secilit punonjës. Në çdo moment është ndërhyrë në rast problemi printimi, konvertim word-pdf / jpg-word / jpg-pdf, etj. Krahas kësaj, në rastet e nevojshme kryhet instalimi i programit të gjuhës shqipe, mirëmbajtja e sistemit audio, hapja e adresave zyrtare (AKSHI), përditësimi i fjalëkalimeve njëherë në tre muaj, sipas rregullores së AKSHI-t, etj. Instalim programesh në kompjuter, sipas kërkesave të secilit punonjës, skanim shkresash, materialesh, problem printimi, etj.



**OBJEKTIVAT E  
INSTITUCIONIT PËR VITIN  
2023**

## 6. OBJEKTIVAT E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2023

---

Objektivat kryesorë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2023:

1. Rritja e kapaciteteve administrative, plotësimi i strukturë/organikës së Autoritetit;
2. Deklasifikimi e dosjeve, duke kufizuar ato që çenojnë sigurinë kombëtare;
3. Fillimi i punës për përdorimim e sistemit të arkivit digjital, për lehtësim të procesit të kërkimit dhe konsultimit me dokumentet arkivore;
4. Sistemimi dhe dixhitalizimi i të gjithë dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të mbledhura nga institucionet arkivore në vend, në arkivin e vetëm të Autoritetit;
5. Shkurtimi i afateve kohore të shërbimit të dokumentacionit, në funksion të përgjigjes së kërkesave të paraqitura nga subjektet e interesuara;
6. Organizimi i veprimtarive hulumtuese dhe ndërvepruese, sipas planit të miratuar dhe kalendarit të kujtesës;
7. Realizimi i konferencave shkencore, dialogëve lokalë, ekspozitave dokumentare dhe të profileve njerëzore, brenda dhe jashtë vendit;
8. Zbatimi i strategjisë së komunikimit në vend dhe jashtë tij, me grupet e synuara, partnerët dhe homologët për zbardhjen e së shkuarës;
9. Trajtimi i çështjes së të zhdukurve në fushën e veprimit të institucionit, përmes akteve ligjore përkatëse;
10. Publikimi dhe shpërndarja e vendimeve, buletinëve, studimeve dhe hulumtimeve shkencore;
11. Bashkëpunimi me institucionet, organizatat kombëtare e ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë në proceset e drejtësisë tranzicionale;
12. Krijimi dhe pasurimi i platformave funksionale e ndërvepruese që qarkullojnë informacionin mbi veprimtaritë e Autoritetit, të përshtatura për të gjitha grupet e synuara, në shqip dhe në anglisht.
13. Krijimi i platformës dixhitale “Të mësojmë mbi të shkuarën”. Autoriteti për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me Agjensinë Telegrafike Shqiptare, Radio Televizionin Shqiptarë, si dhe me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit pasuniversitar;
14. Hartimi i akteve nënligjore në kuadër të përafërimit me ndryshimet që pësoi ligji nr. 45/2015;
15. Përmirësimi i procedurave të brendshme për trajtimin e kërkesave individuale, institucionale, studimore dhe qytetare;
16. Finalizimi i suksesshëm i të gjitha projekteve të nisura gjatë vitit 2022.





# SYNIMET PËR TË ARDHMEN

## 7. SYNIMET PËR TË ARDHMEN

---

Vizioni i Autoritetit është përshtatja me modelet e institucioneve homologe të vendeve ish-komuniste, si institucion kujtuese, ku Autoriteti:

1. Është një platformë e besueshme, me një sistem të sigurt teknologjik të shërbimit të të dhënave, nga ku aksesohet trashëgimia dokumentare e ish-Sigurimit të Shtetit, nga brenda e jashtë vendit, në mundësinë për të kërkuar të dhëna, informacion dhe kontekst nga arkivat e Sigurimit mbi përvojën e shtypjes komuniste;
2. Rrit ndërgjegjësimin e publikut për regjimin komunist, duke dhënë informacion mbi veprimtarinë e Sigurimit dhe kontekstin përkatës, duke ndihmuar në parandalimin e intolerancës, ekstremizmit, lëvizjeve antidemokratike dhe përsëritjen e totalitarizmit;
3. Ndërmerr hapa institucionalë për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm, në komunikimin me familjet, grupet e interesit, pushtetin lokal, organizatat ndërkombëtare, me institucionet shqiptare të ngarkuara për këtë qëllim.
4. Mbështet dhe nxit angazhimin publik, duke mbështetur vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës dhe pajtimit, duke krijuar mjedise të posaçme për leximin, studimin dhe ekspozimin e materialeve arkivore dhe studimeve për periudhën 1944-1991
5. Inkurajon programe edukuese, shkollore, akademike, në disa nivele, pranë dhe për Autoritetin ;
6. Inkurajon ndërtimin e platformave për amendimin e mësimdhënies së historisë, gjuhës e letërsisë dhe edukimit qytetar e filozofisë, duke përdorur mjete ilustruese të besueshme, bazuar në dokumentacionin e administruar në Autoritet.
7. Mbështet trajtimin profesional të pasojave të traumës në viktimat e dhunës gjatë komunizmit, me programe të posaçme mbi trajtimin e viktimave, familjarëve, pasardhësve për gjurmët e së shkuarës në realitetin me të cilin përballen.
8. Mbështet diskutimet e hapura dhe dialogët lokalë për të kaluarën komuniste dhe pasojat e saj, bazuar në transparencë, integritet, bashkëpunim me individë dhe institucione qendrore e të pushtetit lokal.
9. Ndërton bashkëpunime ndërinstitucionale për vënien në vend të dinjitetit të viktimave, personave të thjeshtë apo personaliteteve të përndjekur në diktaturë, të cilët vijojnë të mbajnë stigmën e propagandës komuniste për shtrembërimin e profilit personal e shoqëror në letërsi, art, kinematografi, histori, etj.
10. Mbështet punën për dokumentimin e krimeve të komunizmit, përfshirë kontributin në bërjen e drejtësisë.
11. Krijon facilitetet e duhura nëpërmjet deklasifikimit tërësor të dokumentacionit të administruar nga Autoriteti në shërbim të subjekteve të interesuara (individuale, studimore, mediatike, qytetare, institucionale, të familjarëve të të zhdukurve etj.).

**DETYRIMET LIGJORE NGA  
AUTORITETI DHE  
PËRGJEGJËSITË NË  
RASTET KUR LIGJI ËSHTË  
SHKELUR APO NUK  
ËSHTË KONSIDERUAR**

## 8. DETYRIMET LIGJORE NGA AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSITË NË RASTET KUR LIGJI ËSHTË SHKELUR APO NUK ËSHTË KONSIDERUAR

- a. Në komunikim aktiv me publikun dhe të interesuarit për realizimin e detyrave funksionale, Autoriteti është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, nuk ka pasur raste të tejkalimit apo keqpërdorimit të kompetencave në ushtrimin e funksioneve për të cilat ligji nr. 45/2015, i ndryshuar dhe Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit e ngarkojnë.

- b. Niveli i zbatimit të Kodit të sjelljes së mirë administrative dhe Kodit të Etikës nga sekretariati teknik dhe anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi

Ky kod është krijuar për të promovuar si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit një kulturë administrative, të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, si dhe ofron udhëzime në lidhje me hapat praktikë që duhen ndjekur për të siguruar më shumë efektshmëri, transparencë dhe përgjegjësi. Në këtë kuadër, theksojmë se, në veprimtarinë e përditshme të punës në komunikimet me titullarin, anëtarët e Autoritetit, me kolegët si dhe me subjektet e interesuar që i drejtohen Autoritetit dhe që paraqesin kërkesa për informim, punonjësit e institucioneve të tjera të administratës publike/ personave të tretë të lidhur me ta, udhëhiqet në çdo rast nga respektimi i parimeve bazë të ligjit nr.45/2015 i ndryshuar, të zbatimit të Rregullores “Për organizimin dhe funk-

sionimin e AIDSSH”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit, ndryshuar me vendimin nr. 234, datë 24.04.2019 të Autoritetit, të “Kodit të sjelljes së mirë administrative dhe Kodit të Etikës nga sekretariati teknik dhe anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi”, si dhe të zbatimit të çdo akti tjetër ligjor apo nënligjor që na ngarkon për zbatim.

- c. Veprimtaria në kuadër të ndjekjes dhe zbatimit të ligjit për kontrollin e interesit, pjesë e Autoritetit

1. Hartimi i raportit vjetor të vitit 2021 dhe dërgimi brenda afateve ligjore të Raportit në ILDKPKI.
2. Njoftimi dhe ndjekja e afateve ligjore për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private periodike vjetore, para fillimit në detyrë dhe pas largimit nga funksioni të subjekteve deklaruese të Institucionit.
3. Rakordimi i listës së subjekteve midis Institucionit të Autoritetit dhe ILDKPKI-së.
4. Përgatitja dhe administrimi i gjithë dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të Udhëzimit për Autoritetin Përgjegjes, me qëllim vënien në dispozicion të Institucionit kontrollues dhe monitorues të ILDKPKI.
5. Ndjekja e dorëzimit brenda afateve ligjore të deklaratave të interesave private periodike vjetore, të të gjithë subjekteve deklaruese të Autoritetit.
6. Trajnimi i bërë nga ILDKPI, përsa i përket deklarimit online të interesave private nga ana e subjekteve deklaruese të Autoritetit. Hapja e logarive të secilit prej subjekteve deklaruese

dhe lajmërimi i tyre me anë të e-mail-it dhe të shkresave të protokolluara.

7. Asistencë për secilin nga subjektet deklaruese të Autoritetit, të cilët kanë ndjerë nevojën për ndihmë. Komunikim i vazhdueshëm me nëpunëset e ILDKPI.
8. Afati për dorëzimin e deklaratave të bëra me sistemin online, me Udhëzimin nr. 33, datë 11.03.2022, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPI, është data 31 Tetor 2022.

Në vitin 2022 janë bërë shumë levizje të personelit subjekt deklarimi, të cilët janë njoftuar për deklaratat e tyre “Para fillimit të detyrës” dhe “Pas largimit nga funksioni”, për të cilët është bërë dhe njoftimi i institucionit të ILDKPI-së për ndryshimet në regjistër.

Gjithashtu, për shkak të mbërritjes së moshës së pensionit të një prej Anëtarëve të Autoritetit, përgjegjës të deklarimit të konfliktit të interesit, është bërë urdhri i zëvendësimit të anëtarit me një anëtar tjetër dhe është njoftuar ILDKPI për këto ndryshime.



**NDRYSHIMET NË  
KUADRIN  
RREGULLATOR PËR  
VITIN 2022 DHE  
EFEKTET E TYRE**

## 9. NDRYSHIMET NË KUADRIN RREGULLATOR PËR VITIN 2022 DHE EFEKTET E TYRE

---

Autoriteti në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, ka hartuar një sërë rregullash dhe normash që i vijnë në ndihmë mirëfunksionimit të institucionit, për të bërë më të qartë e transparente vendim-marrjen dhe veprimtarinë e tij, të cilat kryesisht janë si më poshtë:

1. Vendimi i Autoritetit për miratimin e Planit vjetor të veprimtarisë për vitin 2022 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, i cili përcakton drejtimit kryesore të Autoritetit për përmbushjen e detyrave të parashikuara në legjislacionin që normon veprimtarinë e institucionit.
2. Pas një përvoje pesë vjeçare, si dhe të transferimit të arkivës në godinën e re të Autoritetit, doli e nevojshme të hartohej Udhëzimi *“Për rregullat dhe procedurat që ndiqen në arkivin e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish –Sigurimit të Shtetit, mënyrën e përdorimit dhe shfrytëzimit të dokumentacionit arkivor”*, miratuar me Vendimin e Autoritetit nr. 201, datë 5.5.2022.

Gjatë vitit 2022, janë përgatitur dhe nënshkruar katër marrëveshje bashkëpunimi, si më poshtë:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Fondacionit Konrad Adenauer në Shqipëri dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Kjo është një marrëveshje e mbështetur në nevojat që Autoriteti ka për ngritjen e nivelit profesional

të nëpunësve të saj, si dhe përmirësimin e cilësisë së punës dhe shërbimeve që ky institucion ofron. Objekt i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është përfitimi nga Fondacioni Konrad Adenauer në Shqipëri i një burse studimi me vlerë përafërsisht 5.000,00 euro, që përfshin tarifat universitare të vendosura nga universitetet shtetërore në Shqipëri për studentët, punonjës të Autoritetit.

- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Fondacionit Konrad Adenauer në Shqipëri dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Kjo është një marrëveshje e mbështetur në nevojat, që Autoriteti ka për rekrutimin e një eksperti për çështjen e të zhdururve në kohën e komunizmit, pasi Autoritetit i mungon një ekspertizë e mirfilltë në nivel kombëtar dhe ndër-kombëtar.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për garantimin e realizimit të një procesi të rregullt ligjor të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë periudhës së komunizmit.
- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe TV KLAN sh.a., për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimit dhe studimit të dokumenteve e të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit të periudhës 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991 dhe të organeve të diktaturës komuniste. Kjo

marrëveshje do të jetë kontributi i përbashkët në fushën e kujtesës, që çon në rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në njohjen e së shkuarës në dimension të gjerë, nëpërmjet hapësirave e mundësive për ballafaqim me dosjet dhe historitë e komunizmit, për zhvillimin e dialogut të shëndetshëm shoqëror dhe për edukimin e brezave të rinj, në emër të një të ardhmeje më të mirë.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti ka nënshkruar dhe dy Aneks-Marrëveshje, të cilat janë të lidhura me Marrëveshjet e Grantit që institucioni ka nënshkruar me Ambasadën Suedeze në Gusht të vitit 2019. Këto Aneks - Marrëveshje kanë qenë të diktuar nga zgjatja e procedurave të prokurimit për objektin “Sistemi i informacionit arkivor të digjitalizuar” për arsye të publikimit dy herë të kësaj procedure dhe synimit të autoritetit për sigurimin e një Arkive digjitale të sigurt dhe sipas standardeve të kërkuara. Të dy Anekset e nënshkruara konsistojnë vetëm në shtyrjen e afatit të implementimit të Marrëveshjes dhe konkretisht shtyrjen e vlefshmërisë së Marrëveshjes. Të dy aneks - kontratat nuk kanë patur efekte financiare, pra janë konsideruar si zgjatje të afatit të marrëveshjes pa kosto shtesë. Anekset renditen si më poshtë:

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 janë miratuar një sërë urdhrash të nxjerrë nga Titullari i institucionit, në aspektin organizativ dhe funksional, të cilët kryesisht normojnë dhe disiplinojnë veprimtarinë e Sekretariatit Teknik në Autoritet, në bazë të ligjit organik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.



**MBI PROBLEMATIKAT E  
NDESHURA NË  
VEPRIMTARINË E  
AUTORITETIT ME QËLLIM  
GJETJEN E RRUGËVE MË  
EFIKASE PËR ZGJIDHJEN  
E TYRE NGA  
KUVENDI DHE KËSHILLI I  
MINISTRAVE**

## 10. MBI PROBLEMATIKAT E NDESHURA NË VEPRIM-TARINË E AUTORITETIT ME QËLLIM GJETJEN E RRUGËVE MË EFIKASE PËR ZGJIDHJEN E TYRE NGA KUVENDI DHE KËSHILLI I MINISTRAVE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ka paraqitur disa problematika që i ka hasur në punën e tij 6-vjeçare, të cilat përkthehen në propozime të mundshme për të bërë disa ndryshime apo shtesa në ligjin funksional nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo të ndonjë ligji tjetër, të cilët do të ndikonin në cilësinë e punës së Autoritetit.

Problematikat që kanë dalë gjatë veprimtarisë funksionale të Autoritetit janë si më poshtë:

1. Një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit të ish-Sigurimit të Shtetit ndodhet nëpër arkivat e institucioneve si trashëgimi institucionale, e papërdorshme dhe ndoshta jo e njohur mirë nga administratoret e tij dhe kjo ka bërë të mundur apo ngritur shqetësimet dhe paqartësitë, mbi detyrimin e autoriteteve të tjera shtetërore të dorëzojnë dokumente që mund të mos (konsiderohen) të kenë lidhje me atë nocion të paqartë të ish-Sigurimit të Shtetit, pa marrë në konsideratë faktin se Autoritet është institucioni i krijuar me ligj dhe i specializuar për realizimin dhe kryerjen e një procesi të tillë. Gjithashtu, lidhja e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit me veprat penale politike has në vështirësi, duke qenë se një pjesë e madhe e dokumenteve janë të asgjësuara, gjë që sjell vështirësi teknike për stafet e institucioneve dorëzuese dhe institucioneve marrëse. Në këtë këndvështrim, ndryshimi i kësaj dispozite do të lehtësonte procesin e identifikimit dhe dorëzimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, pranë Autoritetit.
2. Autoriteti gjatë ushtrimit të detyrave funksionale është ndeshur me vështirësi dhe vonesa gjatë procesit të deklasifikimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në fondet arkivore, për vënien në dispozicion të akteve të përdorshme subjekteve kërkuese, si rezultat i procesit të gjatë, të parashikuar nga ligji për informacionin e klasifikuar. Për këtë arsye, me qëllim përmirësimin e punës dhe eficiencës e efektivitetit në dhënien e shërbimeve subjekteve kërkuese, lind nevoja për lehtësimin e këtij procesi. Vendosja e një dispozite ligjore për deklasifikim tërësor të dokumentacionit që përfshihet në një nga katër nivelet e klasifikimit, duke përjashtuar ato dokumente që çënojnë sigurinë kombëtare, do të ishte zgjidhja e problemit.
3. Problematikë në vijim është ngarkesa e madhe në sektorin e kërkesave për qëllime studimore/mediatike, për shkak të volumit të dokumenteve objekt anonimizimi. Disa kërkesa shumëfishë dhe voluminoze në disa mijëra faqe, (400 dosje për kërkesë) ngadalësojnë punën për kërkesat e tjera 2020, 2021, për anonimizimin e dokumenteve të praktikave në fjalë. Për këtë lind nevoja e ndihmës në trajtimin e materialit arkivor që do të vihet në dispozicion të studiuesve, me qëllim përshpejtimin e procesit të anonimizimit, kryesisht për praktikat e mbartura pasi janë shumë voluminoze.
4. Autoriteti ka hasur vështirësi në zbatimin e dispozitës të pikës 4, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, i cili, në disa raste, ka dalë me dy ven-

dimarrje të ndryshme, për të njëjtin subjekt, ku në një procedurë Autoriteti është vënë në lëvizje me kërkesë të paraqitur nga institucione kushtetuese apo autoritete publike dhe Vendimmarrja ka rezultuar që subjekti zotëron certifikatën e pastërtisë së figurës së tij dhe në procedurën tjetër, ku Autoriteti është vënë në lëvizje me kërkesë të paraqitur nga persona të prekur nga aktiviteti i strukturave të ish-Sigurimit të Shtetit dhe vendimi tjetër, në të cilin, i njëjti subjekt rezultoi p.sh. si bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit, anëtar i ish Sigurimit, hetues apo gjyqtar. Kjo pasi, dispozita e sipërcituar, pikë e nenit, ka sjellë pengesa dhe ka krijuar veshtirësi. Dokumentacioni i trashëguar mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e këtyre komisioneve jo vetëm që nuk është autentik dhe original, nuk ka kaluar nëpër një proces të mirë dhe të bazuar në rregulla të qarta mbi administrimin e ruajtjes së dokumentacionit zyrtar, nuk ka një inventar të saktë dhe gjatë përpunimit dhe përdorimit të tij kanë rezultuar pasaktësi.

5. Bazuar në praktikën e deritanishme, ku pas verifikimeve lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo është kërkuar nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, në kuadër të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve objekt i këtij ligji për t'u emëruar apo ngritur në detyrë, si dhe individëve në cilësinë e kërkuar, është vërejtur pasaktësi, ose të dhëna jo të plota në dokumentacionin e administruar nga Autoriteti në gjeneralitetet e subjektit gjatë procesit të verifikimit të figurës së pastërtisë së tyre. Për këtë arsye lind nevoja që Autoriteti të përfshihet në një proces hetimi administrativ, ku t'i jepet mundësia që të heto-

jë, jo vetëm brenda dokumentacionit të krijuar nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit, apo të lidhura me to, apo institucioneve përkatëse të mbështetura në dispozitat e ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, por dhe të ketë mundësinë që të thellojë hetimin, duke përfshirë dhe marrjen e informacionit nga persona të tretë që rezultojnë në këta dokumente, në funksion të hedhjes dritë mbi të vertetën, mbi saktësimin e gjeneraliteteve të shtetasit objekt verifikimi.

6. Problematikë për Autoritetin ka qenë mosmiratimi i Vendimit të Këshilli të Ministrave, "Për gjetjen, identifikimin, recuperimin e eshtrave dhe mënyrën e mbrojtjes e ruajtjes së vendvarimeve të personave të zhdukur gjatë periudhës 29 nëntor 1944-2 korrik 1991". Autoriteti ka përgatitur një draft dokument dhe e ka ndarë me institucionet e tjera përgjegjëse si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, etj. Kërkesa për bashkëpunim dhe konsultim me këto institucione e për të pasur komente prej tyre, për këtë çështje, ka krijuar disa divergjenca të rëndësishme mes institucioneve lidhur me tagrat ose kompetencat e secilit institucion, dhe se si duhet të zhvillohet procesi. Ky akt normativ është vendimtar, sepse kuadri ligjor aktual përcakton institucionet përgjegjëse, por nuk parashikon teknikat se si duhet të zhvillohet i gjithë procesi.
7. Bazuar në praktikën e deritanishme të Autoritetit, ku pas verifikimeve lidhur me pastërtinë e figurës të kryera në dokumentacionin arkivor që administrojmë, ka rezultuar se ekzistojnë të dhëna dhe dokumente të krijuara nga struktura të ish –Sigurimit të

- Shtetit për bashkëpunimin me këto struktura (si bashkëpunëtorë, dëshmitarë në procese politike, denoncues etj.), në emër të personave, të cilët më pas janë propozuar për medalje ose tituj nderi në kuadër të harmonizimit ligjor të dispozitave të parashikuara në këtë drejtim, Autoriteti ka paraqitur propozime konkrete që në projektligjin për dhënien e dekoratave të parashikohet një dispozitë për detyrimin e institucioneve/autoriteteve përgjegjëse për dhënien e dekoratave që të paraqesin kërkesë për verifikim të kandidatëve përpara dekorimit ose dhënies së titujve të nderit, me qëllim zhvillimin e procedurave të verifikimit të pastërtisë së figurës të shtetasve të propozuar, për periudhën kohore nga 29 nëntor 1944 deri në datën 02 korrik 1991, si fushë e veprimit të ligjit 45/2015 i ndryshuar, në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore që kanë institucionet shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
8. Që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 45/2015, në zgjedhjet parlamentare dhe vendore të mbajtura, kanë marrë në konsideratë procesin e verifikimit, shumë pak subjekte politike të regjistruara në zgjedhjet përkatëse. Në lidhje me ekzistencën e informacioneve në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për kandidatet për deputetë apo kryetarë bashkie, në zbatim të nenit 30, të ligjit. Kjo mospërfshirje e subjekteve politike zgjedhorë për të sjellë kandidatët e tyre për t'u verifikuar, si një e drejtë që subjektet duhet ta ushtrojnë për qëllime të transparencës së figurës gjatë fushatave elektorale, është shoqëruar me pretendime nga persona të tretë për pastërtinë e figurës së personave të zgjedhur në Kuvendin e Shqipërisë.
  9. Në kuadër të objektivave dhe të angazhimeve të Autoritetit lidhur me ditët e kujtesës si një përpjekje e domosdoshme e shoqërisë shqiptare për nderimin dhe kujtimin e figurave me rëndësi historike, Autoriteti ka propozuar disa ndryshime në ligjin nr. 27/2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”*, konkretisht në nenin 202, pas gërmës “g” shtohen gërmat “gj” dhe “h”, si më poshtë vijon: gj) Muzeu Kombëtar “Kampi i Punës së Detyruar të të Burgosurve Spaç”, h) Muzeu Kombëtar “Kampi i Internimit Tela me Gjemba Tepelenë”;
  10. Si rezultat i kërkesave të shtuara në Autoritet, gjatë vitit 2022, mbi njohjen dhe dëmshpërbimin e viteve të internimit të fëmijëve që kanë jetuar më familjet e internuara, të përfshihen në ligjin përkatës, duke i trajtuar në mënyrë të barabartë me prindërit e tyre.
  11. Transferimi i Autoritetit në ambientet e garnizonit “Skënderbej” ka sjellë vështirësi në aksesin e individëve e studiuësve të ndryshëm, që kërkojnë të vijnë në Autoritet për të plotësuar formularë, tërheqjen/konsultimin e dokumenteve, informacion mbi praktikën, etj. Po ashtu, për shkak të zbatimit të protokolleve të sigurisë së garnizonit, shtetas të huaj e kanë të vështirë të hyjnë në mjediset e Autoritetit. Ndalimi i aksesit në Autoritet dhe kushtet e papërshtatshme për plotësimin e formularit sjellin pakënaqësi tek aplikuesit. Për këtë arsye kërkohet që zona ku ndodhet Autoriteti të jetë zonë civile dhe të mos jetë pjesë e rregullave të garnizonit, si rezultat i kthimit në institucion kujtëse.

The background is a solid teal color. It features several white, stylized calligraphic strokes that resemble Arabic or Persian script, scattered across the lower and right portions of the page. Two white, semi-transparent rectangular shapes are positioned vertically in the center, behind the main text.

**NDRYSHIMET NË KUADRIN  
LIGJOR QË RREGULLON  
VEPRIMTARINË E  
AUTORITETIT DHE  
IMPAKTI I TYRE**

## 11. DRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E AUTORITETIT DHE IMPAKTI I TYRE

---

Me gjithë vështirësitë dhe sfidat e hasura gjatë viteve 2017- 2022, Autoriteti ka kryer me sukses dhe brenda afateve të kërkuara nga institucionet, procedurat për vlerësim të cilësive etike morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u zgjedhur në organet e reja të vetingut dhe atyre për t'u zgjedhur në KLP, KLGJ, KED, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, anëtarë të Gjykatës së Lartë, SPAK, BKH, Inspektoriatit i Lartë i Drejtësisë, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe institucionet e tjera falë kjo dhe shtesave dhe ndryshimeve që iu bënë ligjit organik nr. 45/2015, i ndryshuar.

Në referencë të problematikave të ndeshura, të trajtuara kryesisht në pikën 8, të këtij raporti dhe sa më sipër, ishte imediate nevoja për të ndërhyrë në dispozitat e ligjit organik dhe në këtë kontekst, Autoriteti pas diskutimeve të këtyre ndryshimeve, u paraqiti organeve të legjislativit një Relacion shpjegues për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2015 *“Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, ku në mënyrë të qartë paraqitej problematika për çdo dispozitë që kërkohej ndryshimi, propozimi për ndryshim dhe impakti/synimi që kërkohej.

Miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë me 94 vota pro dhe asnjë kundër, si dhe botimi në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 17.11.2022, të ndryshimeve ligjore, me ligjin 72/2022, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45/2015, datë 30.4.2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, do të kenë ndikim pozitiv në rregullimin e veprimtarisë së Autoritetit në

zbatim të detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 45/2015 dhe praktikave të ndeshura gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të tij, për përmbushjen me sukses të misionit dhe që synojnë:

1. Heqjen e mburojës për figurat e larta publike përmes shfuqizimit të pikës 4, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, i cili përcakton se *“Autoriteti nuk administron kërkesat për informacion për zyrtarët që propozohen të emërohen ose të ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, kur Autoriteti administron apo i është vënë në dispozicion dokumenti autentik origjinal i certifikatës së pastërtisë së figurës, shoqëruar me vendimin përkatës nga institucionet përgjegjëse, si Komisionet Mezini dhe Bezhani”*. Sipas këtij ndryshimi, Autoriteti do të jetë i pavarur, profesional në vendimarrje, i besueshëm për shoqërinë shqiptare dhe faktorin ndërkombëtar, si dhe do të kryejë punën e tij në mënyrë sa më transparente.
2. Deklasifikimi, i të gjithë dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të parashikuara në këtë ligj për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, që disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë, duke u kufizuar në rastet kur gjatë punës ndeshet me dokumente, që përmbajnë informacione, që lidhen me cënimin e sigurisë kombëtare, i klasifikon ato sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar. Ky ndryshim vjen si rezultat i vështirësive dhe vonesave të ndeshura gjatë procesit të deklasifikimit të dokumentave të ish-Sigurimit të Shtetit, me qëllim efektivitetin në përmirësimin e punës në dhënien e shërbimeve subjekteve kërkuese.

3. Thellimin e hetimit, marrja e informacionit nga personat e tretë në funksion të zgjidhjes së problematikave të krijuara rast pas rasti. Ndryshimet ligjore në nenin 5, të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, parashikojnë që *“Çdo person, është i detyruar të bashkëpunojë me Autoritetin dhe kur rezulton që ka dijeni për rrethanat e çështjes, i kërkohet informacion si person i përfshirë ose që, apo kur ai vetë disponon informacion që e ndihmon Autoritetin në punën e tij. Autoriteti ka detyrimin të garantojë konfidencialitetin për çdo person që bashkëpunon, në zbatim të këtij ligji”*. Ky ndryshim i jep mundësinë që të hetojë jo vetëm brenda dokumentacionit të krijuar nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit apo të lidhura me to, apo institucioneve përkatëse të mbështetura në dispozitat e ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, por dhe të ketë mundësinë që të thellojë hetimin, duke përfshirë edhe marrjen e informacionit nga persona të tretë, që rezultojnë në këto dokumente, në funksion të hedhjes dritë mbi të vërtetën mbi saktësimin e gjeneraliteteve të shtetasit apo identifikimin e personave të zhdukur apo ekzekutuar objekt verifikimi apo rrethanave të çështjes duke garantuar në çdo rast, konfidencialitetin e individëve, që ofrojnë informacion si persona të përfshirë ose në dijeni për rrethanat e çështjes.
4. Heqja e “barrierave” për kërkuesit shkencore dhe median, të cilët, me ndryshimet e reja ligjore do të kenë mundësinë të shqyrtojnë dokumente në të cilat nuk do të bëhen të palexueshme, jo vetëm të dhënat e anëtarëve të ish-Sigurimit të Shtetit, si hetues, prokurorë apo gjyqtarë, por edhe të dhënat e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit, përmes kërkesave që kanë në fokus veprimtarinë hulumtuese dhe kërkimin shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit
5. Në kuadër të Edukimit Qytetar dhe informimit të brezave të rinj, përmes përfshirjes në aktivitete përkujtimore, në vende të kujtesës historike, të cilat lidhen me ngjarje e vende që dëshmojnë histori dhe realitete gjatë periudhës 1944-1991, për të dhënë një shtysë në zbatimin e politikave arsimore dhe të formimit historik të të rinjve, në nenin 36, shtohen pikat: *a) Autoriteti bashkëpunon me muzetë kombëtarë të kujtesës, duke vënë në dispozicion të institucioneve të trashëgimisë kulturore, dokumentacionin arkivor që disponon dhe bashkëpunon me to për zbardhjen e së vërtetës së krimeve të komunizmit; b) Autoriteti mbështet organizimin e vizitave shkollore, të inkurajuar dhe sugjeruara nga MASR, si pjesë e programit vjetor, në vendet e kujtesës në ditët përkujtimore historike.*
6. Vendosija e sanksioneve nga Autoriteti, krahas bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese, për të gjitha rastet e keqpërdorimit, apo të shpërndarjes së paautorizuar të informacioneve, apo të dhënave personale që gjenden në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, duke shkelur të drejtat e njeriut, është shtuar dispozita kundërvajtje administrative, edhe me sanksionime, që lidhen me refuzimin ose shmangien për të bashkëpunuar me Autoritetin kur shtetasit i kërkohet të informohet se ka dijeni për rrethanat e çështjes, apo kur ai vetë disponon informacion që e ndihmon Autoritetin
7. Bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të ekzekutuarve, duke shtuar në nenin 22/1, pikën 1.1 *“Në procesin*



*e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të personave të zhdukur dhe të ekzekutuar, në kuadër të Marrëveshjes së Këshillit të Ministrave me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 83/2018, Autoriteti ndërvepron me Ministrinë e Brendshme për sa u takon instrumenteve ligjore dhe institucioneve në varësi të saj". Ky amendin erdhi si rezultat i kompetencave të shtuara për Autoritetin me ndryshimet e fundit ligjore që i janë bërë ligjit nr.45/2015, i ndryshuar, për sa i takon bashkëpunimit për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të ekzekutuarve.*

8. E drejta për t'u njohur me dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, duke shtuar në nenin 20, pika 1.1 *"Çdo person gëzon të drejtën të njihet me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe ka të drejtë të kërkojë një kopje të tyre në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit, me kusht që kërkuesi të paraqesë të dhëna në kërkesën e tij që mundësojnë lokalizimin e informacioneve. Informacioni jepet vetëm kur angazhimi i nevojshëm për gjetjen dhe vënien në dispozicion të informacionit është në përpjesëtim të drejtë me interesin e argumentuar të kërkuarit në marrjen e këtij informacioni. Kërkuesi mban përgjegjësi për keqpërdorimin e informacionit të marrë".* Ky amendament konsensual u hartua nisur nga domosdoshmëria për transparencë të plotë dhe objektive mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, në përputhje me qëllimin dhe parimet e ligjit nr. 45/2015 *"Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, të ndryshuar.

9. Rishikimi i fushës së veprimit të ligjit, që rregullon veprimtarinë e institucioni për të shmangur problematikat e krijuara midis Autoritetit dhe institucioneve të tjera, gjatë procesit të dorëzimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit apo të lidhura me to, sipas akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra në këtë drejtim, që lidhen kryesisht, por pa u kufizuar në veprat penale politike, të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.09.1991. Një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve të krijuar nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit apo të lidhura me to, ndodhet nëpër arkivat e institucioneve si trashëgimi institucionale, e që duhet të dorëzohen pranë Autoritetit të krijuar me ligj dhe të specializuar për realizimin dhe kryerjen e një procesi të mbledhjes dhe administrimit. Ky proces has vështirësi, për shkak të vetë mënyrës së organizimit të ish-Sigurimit të Shtetit, shtrirjes së tij në çdo sektor të jetës, mënyrës së organizimit dhe funksionimit, të administrimit të dokumentacionit në institucione të ndryshme, lidhjes organike të ngjarjeve, personave dhe proceseve, të cilat ose janë iniciuar ose janë mbikëqyrur, apo të ndërlidhura në shumë mënyra e fije me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit.



The background is a solid teal color. In the center, there are two large, semi-transparent numbers, '1' and '2', stacked vertically. Overlaid on these numbers is the main title in white, bold, uppercase letters. At the bottom of the page, there are several lines of dark grey, handwritten-style text that are partially obscured and difficult to read.

# **ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONIT STRUKTURA DHE ORGANIKA E AUTORITETIT**

## 12. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONIT STRUKTURA DHE ORGANIKA E AUTORITETIT

---

Struktura dhe organika e Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.26/2022, datë 17.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit Nr.95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit””, në të cilën u ndryshua numri total i punonjësve nga 60 në 65, por nuk u shoqërua me rritjen përkatëse të fondit të pagave. Nga kjo strukturë konsiston që 5 prej tyre janë Anëtarët e Autoritetit, të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi me vendimet përkatëse; nr.43, nr.44, nr.45, nr.46, nr.47,- datë 09.06.2022.

Për vitin 2022, numri i punonjësve efektivë në total është 51 ose 78.4% e strukturës së miratuar, nga të cilët:

1. Anëtarë të Autoritetit 5
2. Nëpunës Civilë 42
3. Punonjës me “Kod Pune” 4
4. Vende vakante 14

### Punësimi i punonjësve sipas organigramës

Siç është theksuar më sipër në pikën 4, në fund të vitit 2022 rezultojnë 14 vende vakante me fond page për rekrutim janë: - 1 Sekretari i Përgjithshëm; - 6 punonjës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues; - 7 punonjës në nivelin ekzekutiv. Nga ana e Autoritetit janë publi-

kuar vendet vakante të sipërcituara, sipas planit vjetor të rekrutimit, por këto vende kanë mbetur vakante për arsye të dorëheqjes nga pozicioni sipas strukturës të Autoritetit, lëvizjes paralele apo mungesës së kandidatëve të interesuar për procedurat e shpallura.

Gjatë vitit 2022, janë kryer në total 22 procedura rekrutimi, nga e cila njëra në proces. Kanë shprehur interes në këto procedura 48 kandidatë, nga të cilët janë kualifikuar për të hyrë në testim 34 kandidatë. Pas kryerjes së procedurave të përzgjedhjes sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për rekrutimet, janë shpallur fitues 19 kandidatë.


Një pasqyrë e detajuar në lidhje me pozicionet, kategoritë përkatëse, numrin dhe llojin e procedurave të rekrutimit, të shpallura dhe të zhvilluara gjatë vitit 2022, por edhe për procedurat e pashpallur të rekrutimit si për ato të parshikuara në planin e rekrutimeve për vitin 2022, por edhe për vendet vakante të krijuara si rezultat i lëvizjeve të punonjësve ekszisutes jepet në tabelën e mëposhtme:

### Punësimi i punonjësve me kontratë të përkohshme

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.35, datë 19.1.2022, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore”, Autoritetit iu dha e drejta të punësonte 5 (pesë) punonjës me kontratë të përkohshme përkatësisht në pozicionet:

- 1 (një) punonjës me emërtimin “Teknik mirëmbajtje”;
- 2 dy) punonjës me emërtimin “Operator”;
- 1 (dy) punonjës me emërtimin “Punonjës arkive”;
- 1 (nje) punonjës me emërtimin “Punonjës shërbimi”

Struktura dhe organika e re e AIDSSH, është si më poshtë:



### Puna vullnetare pranë Autoritetit

Gjatë vitit 2022, në përgjigje të kërkesave të ardhura për punë vullnetare pranë Autoritetit, janë zhvilluar të gjithë procedurat dhe është plotësuar i gjithë dokumentacioni përkatës për kryerjen e punës vullnetare pranë Autoritetit për 4 (katër) persona, për një periudhë mesatare 3 (tre) – 6 (gjashtë) mujore.

Gjatë vitit 2022, në kuadër të Thirrjes së VII\_të, të “*Programit Kombëtar të Praktikave të Punës*”, të inicuar, drejtuar dhe udhëhequr nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, u realizua bashkëpunimi me këtë Ministri për identifikimin, ndjekjen dhe plotësimin e të gjithë procedurave dhe dokumentacionit përkatës për kryerjen e praktikës pranë AIDSSH nga ana e 2 praktikantëve për një periudhë 3 (tre) mujore.

### Trajnimet e punonjësve

Si rezultat i pandemisë COVID-19, për shkak të masave të distancimit social, ka qenë e vështirë realizimi i trajnimeve të planifikuara. Gjithësesi, gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me ASPA dhe institucione të tjera, janë kryer on-line 24 trajnime, ku përfshihen dhe trajnimet e 6 punonjësve në kuadër të pranimit në shërbimin civil me temë “Prezantimi me Administratën Publike”.

Temat në këto trajnime janë përzgjedhur nga punonjësit për përmirësimin e aftësive menaxheriale dhe ngritjes profesionale, në funksion të realizimit të detyrave sipas pozicioneve të punës apo dhe të detyrave të reja të ngarkuara.

Statusi i punonjësve sipas organigramës dhe ndryshimet deri në muajin dhjetor 2022

Lloji i organit	Autoriteti	Sekretariati Teknik	Të tjerë						
Lloji i punonjësve	Nr:anëtarëve me fond page të aprovuar	Nr:anëtarëve të plotësuar	Nr:punonjësve me fond page të aprovuar	Nr:punonjësve të rekrutuar	Nr:punonjësve të larguar (dorëhequr, lëvizur, institucione të tjera	Punonjës me kohë të pjesshme me kontratë	Punonjës paguar nga projektet		Punonjës vullnetar pa pagesë
							SIDA	ICMP	
2016	5	5							
2017	5	5	15	15		2			4
2018	5	4	25	22	3	6			7
2019*	5	4	35	27	3	14	1	1	12
2020	5	4	45	42	1	4	1	2	7
2021	5	4	55	48	3	4	1	3	7
2022**	5	5	60	51	18	4	1		6

Shpjegime:

\* Fondi i pagave shtesë për 10 punonjës të rinj ka hyre në fuqi me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 3.10.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”

\*\* Numri total i punonjësve të AIDSSH është bërë 65 punonjës, me Vendimin e Kuvendit nr.26/2022, datë 17.3.2022, “Per disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit Nr.95/2016 “Për miratimin e strukturës, organikes dhe Klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” .



**TË DHËNA PËR TË  
ARDHURAT DHE  
SHPENZIMET E  
AUTORITETIT**

### 13. TË DHËNA PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E AUTORITETIT

---

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për vitin 2021 administroi dhe menaxhoi fonde nga disa burime financimi, si më poshtë:

- I. Fondet nga Buxheti i Shtetit, të miratuara me ligjin nr.115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” në vlerën 107,477,000 lekë, ndryshuar me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021”, buxhetin e vitit 2022 në vlerën 101,506,000 lekë.
- II. Të ardhurat dytësore, të cilat realizohen në zbatim të VKM nr. 93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.
- III. Granti i financuar nga Ambasada Suedeze për projektin “Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së Autoritetit dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive moderne”, i cili në datën 1 janar 2022, rezulton me një gjëndje në llogarinë bankare të projektit në Credins Bank në vlerën 67,000,000 lekë.
- IV. Granti i financuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë kalimtare dhe pajtuese, zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste” në vlerën 2,975,145 lekë.

#### I. FONDET BUXHETORE

Me ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit iu miratua numri i përgjithshëm prej 60 punonjësish. Sipas Vendimit nr.95/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar me Vendimin 26/2022 të Kuvendit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin 95/2016 “Për miratimin e strukturës së organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit”, numri i përgjithshëm i punonjësve bëhet 65 punonjës.

Për vitin 2022, me ligjin e buxhetit, fondet e akorduara për institucionin tonë janë 107,477,000 lekë. Me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i reduktoi fondet e Autoritetit në masën 5.971 mijë lekë, duke pakësuar zërin e shpenzimeve për paga dhe shpenzime operative.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2022, me ndryshimet sipas aktit normativ për vitin 2022, janë shpenzuar 88,963693 lekë. Buxheti në tërësinë e tij për periudhën 8-mujore u realizua në masën 52,7 %.

Për periudhën janar-dhjetor 2022, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	B u x h e t i F i l l e s t a r V i t i 2 0 2 2	B u x h e t i m e n d r y s h i m e t V i t i 2 0 2 2	Realizimi faktik 2022	
				Në vlerë	Në %
1	Planifikim-Menaxhim-Adminis- trim	107,477	102,358	88,964	87 %

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik për periudhën janar-dhjetor 2022:

Në mijë lekë

Llog	Emërtimi	B u x h e t i F i l l e s t a r V i t i 2 0 2 2	B u x h e t i m e n d r y s h i m e t V i t i 2 0 2 2	Realizimi faktik Viti 2022	
				Në vlerë	Në %
600	Fondi i Pagave	63,500	61,912	54,623	88 %
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	11,500	11,212	9,100	81 %
602	Mallra dhe shërbime të tjera	20,077	15,982	13,050	82 %
606	Transfertë te individët	400	1,252	1,075	86 %
231	Kapitale të Trupëzuara	2,000	2,000	1,799	90 %
231	TVSH	10,000	10,000	9,317	93 %
	<b>T o t a l i</b>	<b>107,477</b>	<b>102,358</b>	<b>88,964</b>	<b>87 %</b>



## Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore

(Zëri 600-601) është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”. Ky zë shpenzimesh është realizuar për numrin faktik të punonjësve, respektivisht në vlerën 54,623 mijë lekë për paga si dhe 9,100 mijë lekë për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore, rreth 87% e fondit të planifikuar vjetor. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante, ndërkohë që ka vijuar me procedurat e rekrutimit të punonjësve.

Për vitin 2022, janë miratuar edhe 5 punonjës me kontratë të përkohshme, të cilët janë paguar për punën e

kryer (6 orë) duke u trajtuar edhe me sigurime shoqërore.

## Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime

(Zëri 602 - 606), për vitin 2022, është në vlerën 17,234 mijë lekë, ku përfshihen fondi për shpenzime operative në vlerën 15,982 mijë lekë dhe 1,252 mijë lekë janë transferta tek individët, ku 400 mijë lekë janë për pagesën e telefonisë celulare dhe 852 mijë lekë janë pagesa nga fondi i veçantë.

Sipas transaksioneve të kryera në Degën e Thesarit, ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 14,125 mijë lekë ose 82 %, e planit total vjetor të shpenzimeve operative.

Aktualisht realizimi faktik paraqitet si më poshte:

Artikulli	Emërtimi i shpenzimit	Buxheti i rishikuar	Realizuar	
			Në vlerë	Në%
<b>6020</b>	<b>Materiale zyre dhe të përgjithshme</b>			
6020100	Kancelari	899,600	747,600	83%
6020200	Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	470,000	355,080	76%
6020500	Regjistra të arkivës & blerje librash	100,000	76,800	77%
6020900	Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	100,000	95,100	95%
<b>6021</b>	<b>Materiale dhe shërbime speciale</b>			
6021007	Libra dhe publikime profesionale	1,110,400	672,000	61%
<b>6022</b>	<b>Shërbime nga të tretë</b>			
6022001	Energjia	1,592,000	1,380,931	87%
6022002	Ujë	250,000	175,500	70%
6022003	Telefoni fikse	109,380	92,162	84%
6022003	Shërbim interneti	288,000	288,000	100%

	Sim card për sistemin e sigurisë	28,800	0	0%
6022004	Posta dhe shërbimi i korrierit	85,000	79,610	94%
6022009	Dezifektim	120,000	77,999	65%
6022010	Shërbime të printimit dhe publikimit	130,000	62,016	48%
	Shërbim skanimi	1,200,000	888,000	74%
6022099	Shërbime të përkthimit	341,020	339,620	100%
6022099	Shërbim Konsulence (shërbim konsulence)	680,000	138,508	20%
6022099	Shpenzime për ideim dhe konceptim	435,000	435,000	100%
<b>6023</b>	<b>Shpenzime transporti</b>			
6023100	Karburant dhe vaj	270,000	240,000	89%
6023200	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	20,000	16,000	80%
6023300	Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit	40,000	36,345	91%
6023900	Shpenzime për taksa automjeti	40,000	21,076	53%
<b>6024</b>	<b>Shpenzime udhëtimi</b>			
6024100	Udhëtim i brendshëm	500,000	487,500	98%
6024200	Udhëtim jashtë shtetit (Dieta)	1,660,000	1,369,595	83%
6024200	Udhëtim jashtë shtetit (Bileta)	1,140,000	877,471	77%
<b>6025</b>	<b>Shpenzime për mirëmbajtje</b>			
6025300	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	120,000	92,705	77%
6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e programit Alpha	120,000	117,840	98%
6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike	120,000	116,000	97%
6025600	Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit	115,000	80,500	70%
6025600	Shpenzime për larje të automjeteve	72,000	64,800	90%
<b>6026</b>	<b>Shpenzime qeramarrje</b>			
6026400	Shpenzime transporti nga të tretët	450,000	395,290	88%

<b>6029</b>	<b>Shpenzime të tjera operative</b>			
6029001	Shpenzime për artikuj dhe shërbime protokollare	120,000	108,900	91%
6029004	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	900,000	880,000	98%
6029005	Shpenzime për pagesën e anëtarëve të komisioneve	300,000	210,000	70%
6029008	Shpenzime për tatime & taksa të paguara nga institucioni	10,000	10,000	100%
6029007	Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca	1,200,000	1,198,320	100%
6029099	Shpenzime të tjera operative të papërcaktuara	845,800	823,842	97%
<b>606</b>	<b>Transferta tek individë</b>			
6061099	Telefoni Celular, transfera fondi i veçantë	1,251,800	1,074,839	86%
	<b>SHUMA</b>	<b>17,233,800</b>	<b>14,124,949</b>	<b>82%</b>

Diferenca në realizimin e fondeve të parashikuara lidhet kryesisht me fondet e kursyera si rezultat i procedurave të prokurimit.

#### Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231)

Buxheti i akorduar për këtë zë shpenzimesh për vitin buxhetor 2022 është 12,000 mijë lekë, e detajuar si më poshtë:

- 1- Projekti M950002- llog. 231, në vlerën 2,000 mijë lekë, me emërtimin “Blerje orendi, mobilje zyre”, i cili është realizuar në vlerën 1,799 mijë lekë ose 90% e plani të buxhetit për këtë zë të investimeve.
- 2- Projekti 19AH601- llog 231, Tvsh e projektit suedez në vlerën 10,000 mijë lekë, i cili është realizuar në vlerën 9,317 mijë lekë ose 93% të fondit vjetor të planifikuar.

Çdo muaj deri në datën 5 sektori i financës harton pasqyrën mujore dhe progresive të realizimit të shpenzimeve dhe rakordon me Degën e Thesarit.

#### II. TË ARDHURAT DYTËSORE

Këto të ardhura realizohen në zbatim të VKM nr.93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.

Për priudhën Janar- Gusht 2022 janë arkëtuar në total 407,670 lekë, nga të cilat :

1. Nga kërkesat studimore janë arkëtuar në vlerën 362,620 lekë
2. Nga kërkesat individuale janë arkëtuar në vlerën 45,050 lekë.

Të ardhurat e krijuara si më sipër derdhen totalisht në buxhetin e shtetit në kërkesë të vendimit të sipërcituar.

Çdo muaj deri në datën 5 sektori i financës harton pasqyrën mujore dhe progresive të realizimit të të ardhurave dhe rakordon me Degën e Thesarit.

### III. GRANTI I FINANCUAR NGA AMBASADA SUEDEZE

Gjithashtu, Sektori i financës ndjek pagesat e fondeve të financuara nga Ambasada Suedeze për projektin “Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK, për krijimin e një arkive moderne”. Fondi i përgjithshëm i financuar nga Ambasada Suedeze për vitin 2022 është 67.000.000 lekë.

Treguesit e realizimit të zërave të shpenzimeve të projektit, të cilat çdo datë 5 të muajit dërgohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Llogaria	Vlera në lekë
600 Paga	1,452,000
601 Sigurime	242,284
602 Komisione bankare	15,600
231 Investime	55,030,977
<b>TOTALI</b>	<b>56,741,061</b>

Ndërkohë, me fondet e buxhetit të shtetit është paguar TVSH e projektit në shumën 9,317 mijë lekë.

### IV. GRANTI I FINANCUAR NGA KOMISIONI NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Granti i financuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë kalimtare dhe pajtuese, zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste” në vlerën 2,975,145 lekë.

Për vitin 2022 janë shpenzuar në total 2,839,416 lekë, nga të cilat:

- a. Shpenzime për paga dhe sigurime në vlerën 730,680 lekë
- b. Shpenzime operative në vlerën 2,108,736 lekë.

Ky projekt është realizuar dhe ka përfunduar.

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 është bërë me përgjegjësi dhe është kërkuar angazhimi i të gjitha strukturave të Autoritetit, me qëllim realizimin me eficiencë dhe efektivitet të fondeve të planifikuara për vitin 2022. Problemet e konstatuara gjatë kësaj periudhe do të jenë objekt i vëmendjes dhe trajtimit për vitin 2023.

### V. PROKURIMET

Në funksion të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2021, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në bazë të buxhetit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Autoritetin, për vitin 2021, në fillim të vitit është hartuar regjistri i parashikimeve për vitin 2022, në të cilin janë parashikuar procedurat e prokurimit për shërbime e mallra të domosdoshme dhe të nevojshme për veprimtarinë e institucionit.

Janë zhvilluar një pjesë e mirë e procedurave të prokurimit, të parashikuara në Regjistrin e parashikimeve të vitit 2022, të cilat kanë bërë që fondet e buxhetit të shtetit, të akorduara për Autoritetin për vitin 2022, të realizohen në masën 82%. Procedura të rëndësishme të kryera gjatë vitit 2022, nga fondet e Grantit të akorduar nga SIDA (Qeveria Suedeze) kanë qenë “Blerje orendi, mobilje zyre”, “Shërbime TIK, për krijimin e një sistemi të arkivit digjital”, etj.

Vlen të përmendet që të gjitha procedurat e prokuruar, të realizuara apo jo, janë kryer në mënyrë transparente dhe me integritet të plotë nga njësitë e prokurimit, komisionet e vlerësimit të ofertave, komisionet e shqyrtimit të ankesave dhe të marrjes në dorëzim.

Përkthyer në shifra planifikimi i regjistrit të parashikimeve të Autoritetit dhe realizimi i tij për vitin 2022 përbëhet nga:

- 1) Planifikimi i regjistrit të parashikimeve me fondet e buxhetit në vlerën 10.250 mijë lekë. Realizimi i prokurimeve për këtë vlerë është 8.663 mijë lekë ose 84.5%.
- 2) Planifikimi i regjistrit të prokurimeve me fondet e projektit SIDA, financuar nga Ambasada Suedeze në vlerën 64.220 mije leke. Realizimi i prokurimeve të projektit për këtë vlerë është 55231 mijë lekë ose 86%.

Ne total, planifikimi i regjistrit të prokurimeve, ku përfshihet plani i buxhetit dhe granti i financuar nga Ambasada Suedeze, është 74470 mije lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 63894 mijë lekë ose 85.7%.

## VI. LOGJISTIKA

Më datë 27 qershor 2022, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në Tiranë (SIDA), zhvilluan ceremoninë e përirimit të ndërtesës së rikonstruktuar të Autoritetit dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkivi modern, në mjediset aktuale të Autoritetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë vitit 2022, është mundësuar mirëfeksionimi i zyrave të reja të Autoritetit, duke realizuar blerjen dhe instalimin e paisjeve ngrohëse-ftohëse HVAC, si dhe zëvendësimin dhe përshtatjen e dritareve, vetratave ekzistuese të Godinës së Re të Autoritetit, duke garantuar një infrastrukturë bashkëkohore në ambientin e punës.

Janë kryer procedurat për sigurim të objektit dhe pajisjeve, si dhe është kontraktuar me kompanitë e sigurim-

it, me qëllim mbrojtjen e investimit nga dëmtimet.

U realizua me sukses procesi i transportit fizik të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, të cilat ruhen në arkivin që ndodhet në ambientet e Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, IPQP.

Janë ruajtjur dhe mirëmbajtur aktivet në pronësi të Autoritetit. Është siguruar mbarëvajtja e eventeve të organizuara nga Autoriteti, ku përfshihet suporti teknik, transporti i materialeve, menaxhimi i hapësirave dhe burimeve njerëzore për kryerjen e tyre.

Në muajin tetor 2022, me përfundimin e periudhës së garancisë së punimeve të rikonstruksionit, është realizuar marrja përfundimtare në dorëzim e punimeve të rikonstruksionit, e cila garanton sigurinë se punimet janë kryer sipas standardit.

## VII. KALLËZIMET PENALE DHE PROCESET GJYQËSORE, KU INSTITUCIONI KA QENË PALË NË PROCES

Për sa i takon kallëzimeve penale drejtuar Autoritetit gjatë vitit raportues 2022, rezulton se është ngritur vetëm një kallëzim penal, nga kallëzuesi I.M., për të cilin Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi nuk ka vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka pranuar ankimimin e bërë nga kallëzuesi dhe ka rrëzuar vendimin e Prokurorisë për mos fillimin e hetimeve.

Më poshtë renditen të detajuara çështjet gjyqësore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit në proceset gjyqësore, ku institucioni ka qenë palë në proces.

<b>Nr.</b>	<b>Paditës</b>	<b>Faza e procesit</b>	<b>Komente</b>
<b>1</b>	<b>S.B.</b>	Çështje gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë	<p>Paditës S.B. me objekt “Shfuqizimi i akteve administrative të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, për “Mospranimin e kërkesës për korrigjimin e të dhënave si të pasakta në dokumentacion”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë ka rrëzuar kërkesën e paditësit.</p> <p>Paditësi ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.</p>
<b>2</b>	<b>B.Sh.</b>	Çështje Gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë	<p>Parashtrime për ankimimin drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë në gjykimin në dhomë këshillimi, të çështjes administrative, me objekt “Ankimi ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë-padisë të paditësit B.Sh. Gjykata ka vendosur mos pranimin e ankimit</p>
<b>3</b>	<b>G.Gj.</b>	Çështje Gjyqësore në proces në Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	<p>Paditësi G. Gj. avokat dhe përfaqësues ligjor i shtetasit I.M. me objekt “Detyrimin e organit administrativ Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e Ish- Sigurimit të Shtetit për të kryer veprimin administrativ pajisjen e kërkuarit me aktet e kërkuara me kërkesën e datës 14.09.2022”.</p> <p>Çështja është në gjykim.</p>
<b>4</b>	<b>I.M.</b>	Çështje Penale në proces në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë	<p>Kallëzimi penal i vitit 2022 i shtetasit I.M. drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kundër anëtarëve të Autoritetit. Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi nuk ka vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka pranuar ankimimin e bërë nga kallëzuesi dhe ka rrëzuar vendimin e Prokurorisë për mos fillimin e hetimeve. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim kundër vendimit të Gjykatës Penale të Shkallës së Parë.</p>





AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT